




Bashkë-financuar nga
Bashkimi Evropian

Bashkë-financuar nga
Suedia



Sweden
Sverige



INTEGRIMI I PERSPEKTIVËS GJINORE NË PROCESIN E ANËTARËSIMIT NË BE

Raporti i Vlerësimit për Kosovën

Kosovë

2022

Organizata partnere






Bashkë-financuar nga
Bashkimi Evropian

Bashkë-financuar nga
Suedia



Sweden
Sverige



INTEGRIMI I PERSPEKTIVËS GJINORE NË PROCESIN E ANËTARËSIMIT NË BE

Raporti i Vlerësimit për Kosovën

Kosovë

2022

I përgatitur nga Valmira Rashiti dhe Nicole Farnsworth
për Rrjetin e Grave të Kosovës

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare nga Bashkimi Evropian dhe në bashkëfinancim nga Suedia. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Rrjetit të Grave të Kosovës dhe nuk pasqyron domosdoshmëri pikëpamjet e Bashkimit Evropian apo Suedisë.

HYRJE

Kosova e ka dorëzuar aplikacionin e saj për anëtarësim në BE në dhjetor 2022, prandajende nuk është hapur asnjë kapitull i Acquis për shqyrtim.² Ndërkohë, Qeveria e Kosovës dhe Bashkimi Evropian (BE) kanë bërë disa zotime për avancimin e barazisë gjinore, duke përfshirë edhe disa sosh që ndërlidhen me procesin e anëtarësimit në BE. Duke u bazuar në treguesit zyrtarë të politikave dhe në metodologjinë e përbashkët në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor (BP), kjo përmbledhje e politikave monitoron dhe raporton mbi progresin e bërë në avancimin e barazisë gjinore sa i përket proceseve kyçe që lidhen me anëtarësimin në BE dhe dialogun politik në vitin 2022. Ky dokument synon t'u ofrojë zyrtarëve të qeverisë dhe BE-së njohuri dhe rekomandime se si të përmirësohet dhe përfshihet më tej perspektiva gjinore brenda këtyre proceseve, si dhe të informojë organizatat e grave të shoqërisë civile (OSHCG) drejt synimit të një qasje transformuese gjinore në avokimin e tyre ndaj procesit të anëtarësimit në BE. Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka monitoruar dhe ka përpiluar këtë raport, duke përdorur metodologjinë e zhvilluar nga organizatat partnere të Koalicionit për Avancimin e Barazisë Gjinore përmes Procesit të Anëtarësimit në BE (EQUAPRO) si pjesë e iniciativës sonë të përbashkët "Avancimi i barazisë gjinore përmes procesit të anëtarësimit në BE", të bashkëfinancuar nga Komisioni Evropian dhe Suedia. Treguesit e përdorur rrjedhin nga [Komunikimi i përbashkët për Planin e ri të Veprimit Gjinnor III – Një Agjendë Ambicioze për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Veprimin e Jashtëm](#) shoqëruar nga [Objektivat dhe treguesit](#) e tij si dhe i njohur si Plani i Veprimit Gjinnor III i BE-së (PVGj III). Monitorimi përqendrohet në dy akterë kryesorë përgjegjës për integrimin e perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në BE: BE-në dhe organet qeveritare. Është për t'u theksuar se organe të shumta të BE-së operojnë në Kosovë dhe ato të cilat konsiderohen si më relevante për këtë monitorim janë: Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (ZBEK), Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (PSBE) në Kosovë dhe [Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit](#) (EULEX). Metodologjia e përdorur për monitorim në këtë dokument përfshiu përdorimin e metodave të përziera, duke përfshirë analizën e përmbajtjes, vëzhgimin e pjesëmarrësve dhe kërkesat e të dhënave nga aktorët kryesorë. Në tabelat përkatëse në vijim, për secilin tregues, krahasohen gjetjet e Raportit të Monitorimit të përpiluar në vitin 2021 dhe 2022. Në kolonën e fundit të secilës tabelë vlerësohen ndryshimet, duke përdorur shkallën krahasuese pesë pikëshe, ku "-1" ilustron rënie të konsiderueshme të rezultateve, "-0.5" tregon një rënie të lehtë, "0" tregon se nuk ka pasur ndryshim, "0.5" ilustron disa përmirësime, ndërkohë "1" nënkupton që ka pasur përmirësim të konsiderueshëm ose implementim të plotë. Ky sistem vlerësimi përdoret për të shqyrtuar regresin ose progresin e përgjithshëm në integrimin e një perspektive gjinore në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

GJETJET

Në këtë seksion janë paraqitur gjetjet, të ndara në nën-seksione për secilin tregues, duke përfshirë tabelat përmbledhëse për secilin tregues, të pasuara me nga një shpjegim të shkurtër cilësor.

A. RAPORTET PËR VENDIN KANË TË INTEGRUAR PERSPEKTIVËN GJINORE

Në këtë seksion shqyrtohet deri në cfarë niveli u integrua perspektiva gjinore në raportin për vendin, duke iu referuar Raportit të Komisionit Evropian (KE) për Kosovën, të vitit 2022.³ Treguesit e përdorur rrjedhin nga PVGj III, veçanërisht nga zotimet e BE-së për të siguruar një qasje transformuese gjinore dhe integrimin e perspektivës gjinore në dialogun politik, të sigurisë dhe sektoral.⁴ Raporti për Kosovën është dokument kyç që orienton dialogun politik të BE-së me

² Parlamenti Evropian, [Fletë informuese mbi Parlamentin të Bashkimit Evropian](#).


³ KE, [Dokument i punës i stafit – Raporti për Kosovën 2022](#), Bruksel, 12 tetor 2022.

⁴ PVGj III, objektiva 7.

Qeverinë e Kosovës dhe përfshirja e perspektivës gjinore në Raport mund të kontribuojë në sigurimin që çështjet kyçe sa i përket barazisë gjinore të integrohen në dialogun me qeverinë në sektorë të ndryshëm. Në tabelën A në vijim janë të përmbledhura gjetjet.

Tabela A. Sa është integruar perspektiva gjinore në Raportin për Kosovën 2022	2021	2022	Ndryshimi
1. Sa herë është përmendur gjinia në Raportin për Kosovën	28	38	0.5
2. Sa herë janë përmendur gratë/vajzat/femrat në Raportin për Kosovën	57	73	0.5
3. Sa herë janë përmendur djemtë/burrat/meshkujt në Raportin për Kosovën	13	11	-0.5
4. Përqindja e kapitujve që kanë përfshirë perspektivën gjinore ⁵	50%	37%	-0.5
5. Numri i rekomandimeve zyrtare për barazinë gjinore në Raportin për Kosovën ⁶	3	4	0.5
6. Numri i rekomandimeve të tjera me perspektivë gjinore në kapituj	44	35	-0.5
7. Niveli i përdorimit të të dhënave të ndara sipas gjinisë në Raportin e Kosovës për vitin 2022	I moderuar	I moderuar	0
8. Niveli i përfshirjes së çështjeve të rekomanduara nga OSHCG	E moderuar: 50%	Dukshëm: 70 %	0.5

Çdo vit, RrGK së bashku me OSHCG-të e ndryshme anëtare, hartojnë një komentari të detajuar mbi atë se sa i ka marr parasysh Raporti i KE-së për Kosovën çështjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. Është e preferueshme që, në përputhje me zotimet e BE-së, të gjithë kapitujt e Raportit të kenë të integruar perspektivën gjinore. Komentari i vitit 2022 mbi Raportin e KE-së për Kosovën tregoi se krahasuar me vitet e mëparshme, Raporti ka vazhduar të përmirësohet sa i përket shkallës në të cilën kontributi i ofruar nga OSHCG-të gjatë konsultimeve u integrua në raport dhe shkallës sa u përfshi aspekti gjinor në kapituj të ndryshëm, si dhe në formulimin që lidhet me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave.⁷



Në përgjithësi, Raporti përmend gratë, burrat, barazinë gjinore dhe gjininë më shumë se në vitet e mëparshme, duke arritur numrin prej gjithsej 125 herë (shih Grafikun 1). Raporti trajton çështjet e barazisë gjinore në 13 tema të ndryshme, duke përfshirë dhunën me bazë gjinore dhe trafikimin e qenieve njerëzore; pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe diskriminimin në vendin e punës; pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje; dhe pushimin prindëror. Pavarësisht progresit, Raporti i KE-së për Kosovën ende duhet të përmirësohet në kuptimin e fokusit dhe vëmendjes së shtuar ndaj barazisë gjinore në të gjithë kapitujt, pasi aktualisht, vetëm 11 nga 30 kapitujt kanë trajtuar çështjen e barazisë gjinore. Një nga rekomandimet kryesore të RrGK-së lidhur me Raportin e vitit 2021 ishte se duhej të forcohej gjuha sa i përket barazisë gjinore.⁸ Ka pasur disa përmirësime në këtë aspekt, pasi katër rekomandimet zyrtare në Raport adresojnë drejtpërdrejt barazinë gjinore:

⁵ Kapitujt ishin konsideruar sikur të ishte "përfshirë perspektiva gjinore" në ta, nëse i kushtonin vëmendje çështjeve që kanë të bëjnë me barazinë gjinore brenda atij kapitulli.

⁶ "Rekomandimet zyrtare" janë definuar në atë mënyrë për t'i përfshirë ato në kutitë gri, dhe "rekomandimet e tjera" si ato në seksionet e tjera, të formuluar si: "Kosova duhet të ...".

⁷ RrGK, Komentari: [Leximi nga perspektiva gjinore i Raportit të Komisionit Evropian për vendin of](#), 2022.

⁸ RrGK, [Leximi nga perspektiva gjinore i Raportit të Komisionit Evropian 2021](#).

- Për të Drejtat Themelore: “Të forcojë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore; të miratojë Ligjin për dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave; të vazhdojë përpjekjet për të siguruar funksionimin e duhur të sistemit të mbrojtjes, parandalimit dhe gjyqimit të të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore duke zbatuar strategjinë dhe planin përkatës të veprimit;”
- Për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë: “Të zbatojë strategjinë dhe planin e veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2022-2026, duke miratuar një qasje me viktimit në qendër;”
- Për Zhvillimin Ekonomik dhe Konkurrencën: “Të zbatojë masat aktive të tregut të punës për të mbështetur punësimin; të rifillojë publikimin e të dhënave të anketës së fuqisë punëtore dhe të vazhdojë zbatimin e masave që synojnë formalizimin e punësimit joformal.”
- Për Politikën Sociale dhe Punësimin: “Të miratojë Ligjin e ri për Punën në përputhje me legjislacionin (*acquis*) përkatës të BE-së, veçanërisht në lidhje me mosdiskriminimin në punësim dhe pushimin prindëror.”

Raporti për vitin 2022 përdori të dhëna të ndara sipas gjinisë në nivel të moderuar, duke lënë hapësirë për përmirësime të mëtejshme. Të dhënat e ndara sipas gjinisë u prezantuan në lidhje me tregun e punës (p.sh., shkalla e papunësisë së popullsisë së moshës 15-64 vjeç, duke përfshirë “femra” 29.7 dhe “meshkuj” 24.2).⁹ Megjithatë, ato nuk u prezantuan sa i përket sektorëve tjerë kyç. Për shembull, në Raport thuhet se “Të dhënat e administratës tatimore sugjerojnë se punësimi zyrtar në sektorin privat dhe publik u rrit për 10% në vitin 2021”.¹⁰ Këtu nuk është diferencuar përqindja e grave dhe burrave të punësuar, sipas kërkesave të Ligjit për Barazi Gjinore (LBGj). Në mënyrë të ngjashme, për arsimin, Raporti vë në dukje se “Matjet e fundit sa i përket mospërputhjes së aftësive me tregun e punës tregojnë se mbi 40% e punëtorëve të rinj me arsim terciar janë të punësuar në vendet e punës që janë nën nivelin e tyre të arsimit”.¹¹ Tek përqindja e punëtorëve të rinj nuk është përfshirë përqindja e grave dhe burrave.

Në përgjithësi, Raporti adresoi 70% të rekomandimeve të dhëna nga anëtarët RrGK-së. Megjithëse më shumë komente u integruan në vitin 2022 sesa në vitin 2021, ato u shpërndanë në më pak kapituj se në vitin 2021. Shumica e rekomandimeve të RrGK-së janë adresuar në seksionin që flet për barazinë gjinore në kuadër të seksionit për të drejtat themelore; ndërkohë, më pak rekomandime që lidhen me barazinë gjinore ekzistonin në kapitullin për Politikën Sociale dhe Punësimin në vitin 2022. Rekomandimi për më shumë të dhëna të ndara sipas gjinisë nuk është marrë në kapitullin ku janë diskutuar statistikave, edhe pse rekomandimi i tillë ishte i përmendur në Raportin e Kosovës 2021. Përkundër kësaj, për vitin 2022, Raporti i KE-së për Kosovën tregoi progres në përfshirjen e një perspektive më të plotë ndërthurëse si dhe me pranimin e kontributit dhe komenteve nga anëtarët e RrGK-së që përfaqësojnë të drejtat e grave të nivelit lokal dhe personave me aftësi të kufizuara.

B. NIVELI I PËRFSHIRJES SË ÇËSHTJEVE GJINORE NË TAKIMET E STRUKTURAVE TË STABILIZIM-ASOCIMIT

Ky kriter shqyrton deri në cilën masë është përfshirë perspektiva gjinore në strukturat e përbashkëta institucionale të stabilizim-asociimit, të krijuara përmes Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim (MSA) ndërmjet BE-së dhe Kosovës. Këtyre, në vijim, i'u referohemi si struktura të MSA-së. Strukturat e monitoruara të MSA-së në këtë raport përfshijnë takimet e Komiteteve të MSA-së dhe Komitetit të MSA-së, të mbajtura në vitin 2022. Takimet e strukturave të MSA-së janë ndër mënyrat kryesore përmes të cilave BE zhvillon dialogun politik dhe atë për politika, duke diskutuar reformat e anëtarësimit në BE me qeveritë dhe institucionet e tjera publike (si parlamentet, institucionet e drejtësisë, rregullatorët, etj.) në BP. Prandaj, për t'u

⁹ KE, [Dokument i punës i stafit – Raporti për Kosovën 2022](#), Bruksel, 12 tetor 2022.

¹⁰ Po aty, f. 66.

¹¹ Po aty, f. 67.

siguruar që agjendat dhe konkluzionet e takimeve të MSA-së i kanë në fokus çështjet e barazisë gjinore, aty ku janë relevante për sektorët, është e rëndësishme si pjesë e zotimeve në kuadër të PVGj III të ngriten çështjet e barazisë gjinore në hartimin dhe zbatimin e reformave të anëtarësimit në BE në vendet përkatëse. Si eksperte në këto çështje, OSHCG-të mund të ofrojnë mbështetje të rëndësishme BE-së dhe qeverive të vendeve si dhe institucioneve tjera publike në identifikimin e çështjeve kryesore të barazisë gjinore dhe pabarazive që kërkojnë diskutim dhe vëmendje.

Tabela B. Sa janë të përfshira çështjet gjinore në takimet e strukturave të MSA-së	2021	2022	Ndryshimi
9. Përqindja e takimeve të Komitetit të MSA-së që kishin në agjendë çështjet e barazisë gjinore	100%	100% ¹²	1
10. Përqindja e takimeve të NK të MSA-së që kishin në agjendë çështjet e barazisë gjinore	33%	33%	0
11. Niveli i konsultimit të OSHCG-ve nga BE-ja para mbajtjes së takimeve të NK	E moderuar	E moderuar	0
12. Niveli i vëmendjes ndaj çështjeve të barazisë gjinore në konkluzionet e dala nga takimet e Komitetit të MSA-së dhe të Komitetit	33% (NK MSA) 50% (K MSA)	40% (NK MSA) 50% (K MSA)	0.5

Në vitin 2022, sipas kalendarit vjetor të konsultimeve të qeverisë me OSHC-të dhe akterët e tjerë në kontekstin e raundit të gjashtë të strukturave të MSA-së, u mbajtën të gjitha takimet konsultative në kuadër të raundit të gjashtë të mbledhjeve të strukturave të MSA-së, duke përfshirë edhe një takim të Komitetit të MSA-së dhe shtatë takime të NK të MSA-së, gjashtë prej të cilëve RrGK i ka monitoruar nga perspektiva gjinore. RrGK ka pranuar vazhdimisht ftesat, agjendat dhe konkluzionet nga qeveria në lidhje me të gjitha takimet. BE-ja ka organizuar gjithashtu konsultime paralele me shoqërinë civile para mbajtjes së takimeve të strukturave të NK të MSA-së. Megjithatë, nga ZBE, RrGK-ja ka pranuar ftesa vetëm sa i përket tre takimeve konsultative të NK të MSA-së, duke përfshirë ato mbi 1) Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë; 2) Inovacionin, Politikën Sociale dhe Punësimin; si dhe 3) Ekonominë, Çështjet Financiare dhe Statistikat. Pra, RrGK vlerësoi se konsultimet e BE-së me shoqërinë civile përpara mbajtjes së këtyre takimeve janë bërë në një masë mesatare. Gjatë këtyre konsultimeve, përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë mundur të ndajnë pikëpamjet e tyre mbi përmbajtjen e agjendës dhe pikat e diskutimit. Në shumicën e konsultimeve, RrGK ka përgatitur dhe ka dhënë kontributin e saj përmes komenteve se si pikat e agjendës mund të marrin parasysh dhe të fokusoheshin më mirë në barazinë gjinore. OSHCG-të anëtare të RrGK-së, përfshirë Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, Komitetin e Grave të Verbra të Kosovës dhe EcoKos Women morën pjesë dhe dhanë kontribut në disa nga këto takime nga perspektiva ndërthurëse. BE-ja kishte tendencë të jepte përgjigje të menjëhershme shoqërisë civile gjatë këtyre konsultimeve, ose, sipas rastit, u kthehej përfaqësuesve të shoqërisë civile më pas për t'u përgjigjur në pyetjet dhe rekomandimet e tyre të bëra gjatë konsultimeve. Edhe pse konsultimet janë të hapura, pjesëmarrja e shoqërisë civile vazhdon të jetë e ulët, dhe OShC të ndryshme përfshirë OSHCG-të, nuk kanë marrë gjithmonë pjesë. Disa OSHCG të përmasave të mesme, veçanërisht ato jashtë Prishtinës, thanë se nuk kishin marrë ftesa për të marrë pjesë në konsultime nga BE-ja apo Qeveria. Barrierat gjuhësore (pasi shumica e konsultimeve janë mbajtur në gjuhën angleze), vendndodhja e mbajtjes së konsultimeve në Prishtinë dhe njohuritë minimale për procesin e anëtarësimit në BE dhe mbi atë si ato të angazhohen në të kanë qenë faktorë që kufizojnë pjesëmarrjen e organizatave më të vogla, *grassroots* (organizata të komuniteteve lokale).

Po ashtu, Qeveria e Kosovës ka përfshirë shoqërinë civile në konsultimet publike që lidhen me takimet e MSA-së që nga viti 2017, pas miratimit të Rregullores për Standardet

¹² Nga korrespondencat me ZKM-në, RrGK mësoi se vetëm një takim i Komitetit të MSA-së është mbajtur në vitin 2022. Përqindja është bazuar në konkluzionet e marra.

Minimale për Procesin e Konsultimit Publik.¹³ Nga një perspektivë tjetër, sipas Zyrës së Kryeministrit (ZKM), Qeveria ka filluar mbajtjen e takimeve konsultative që nga viti 2018 kur Ministria e atëhershme e Integritimit Evropian nxori udhëzuesin për konsultime të tilla. Ato nuk janë të detyrueshme sipas Rregullores për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, por paraqesin një mekanizëm të veçantë të krijuar vullnetarisht nga ish-Ministria e Integritimit Evropian.¹⁴ Konsultimet e organizuara nga qeveria mbahen në gjuhën shqipe, me përkthim në gjuhën serbe, në rastet kur marrin pjesë përfaqësues të OSHC-ve nga komuniteti serb.¹⁵ RrGK ka marrë pjesë vazhdimisht në këto konsultime që kanë ndodhur para çdo takimi të MSA-së ose ka dhënë kontributin e saj përmes komenteve me shkrim për të informuar më shumë këto procese. Që nga viti 2019, RrGK ka vërejtur përmirësime të rëndësishme në përfshirjen e shoqërisë civile nga Qeveria në procesin e anëtarësimit në BE, veçanërisht OSHC-të më të mëdha me seli në Prishtinë. RrGK ka pranuar vazhdimisht pikat e planifikuara të agjendës për takimet e strukturave të MSA-së, ftesat për të marrë pjesë në konsultime ose për të dhënë kontributin e saj me shkrim, si dhe përfundimet nga takimet më pas. Krahësuar me gjetjet në Raportin e Vlerësimit për Kosovën të vitit 2021, Qeveria ka vazhduar të jetë njëlojë konsistente në ftesën dhe përfshirjen e OSHC-ve për të marrë pjesë në konsultime publike. Megjithatë, nuk ka pasur zhvillime në kuptim të sigurimit të pjesëmarrjes më gjithëpërfshirëse të OSHC-ve të ndryshme në këto konsultime, ose të hulumtimit dhe gjetjes së OSHC-ve që do të mund të kontribuonin në secilën fushë tematike të NK të MSA-së, ashtu siç kishte këshilluar RrGK më parë. Një sfidë tjetër me të cilën përballë ky mekanizëm konsultativ është pjesëmarrja aktive e OSHC-ve, me disa takime konsultative që nuk janë mbajtur për shkak se kanë marrë pjesë vetëm një ose dy pjesëmarrës të OSHC-ve. Më tej, agjendat dhe konkluzionet nuk janë në dispozicion për publikun, edhe pse Departamentet e Integritimit në BE të ZKM-së, i sigurojnë ato sipas kërkesës. Qeveria ka një faqe interneti funksionale për strukturat e Integritimit Evropian, e cila, ndër të tjera, ofron përditësime mbi proceset dhe dokumentet e integritimit në BE.¹⁶ Përfundimet nga konsultimet dhe takimet e strukturave të MSA-së mund të ishin bërë publike këtu; publikimi i tyre do të lehtësonte rishikimin dhe analizën e tyre, si dhe do t'i mundësonte shoqërisë civile që ta mbajë Qeverinë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve, siç kishte theksuar RrGK-ja vitin e kaluar.

Analiza e agjendave përfundimtare të takimeve të NK të MSA-së dhe përfundimeve të dhëna nga ZKM-ja sugjeronte që dy nga gjashtë takimet e NK të MSA-së (33%) që RrGK ka monitoruar përmbanin fokus në çështjet e barazisë gjinore në agjenda dhe konkluzione. Takimi Konsultativ i NK i MSA-së dhe konkluzionet përkatëse lidhur me Ekonominë, Çështjet Financiare dhe Statistika kishte përsëritur një nga pikat kyce të avokimit të RrGK-së: “ Qeveria duhet të përmbahet nga miratimi i çfarëdo iniciative të re për pensionet dhe skemën sociale pa i shqyrtuar të gjithat skemat ekzistuese sociale dhe iniciativat e reja, në veçanti pensionet e bazuara në kategori, siç është rënë dakord në udhëzimin e politikave ERP 3”. Megjithatë, RrGK kishte rekomanduar poashtu në mënyrë specifike që të bëhet një rishikim nga perspektiva gjinore i skemave sociale, gjë që nuk ishte e specifikuar në përfundime. Prandaj, ky rekomandim u konsiderua se është zbatuar pjesërisht.

Qeveria gjithashtu i dërgoi përfundimet dhe ftesat Shoqërisë Civile për takimin e parë konsultativ në kuadër të takimit të Komitetit të MSA-së, të mbajtur në maj 2022; konkluzionet dhe agjendat e të cilave kishin në fokus barazinë gjinore. Një takim i Komitetit të raundit të gjashtë ishte planifikuar të mbahet edhe në tetor 2022, por është shtyer për muajin shkurt 2023 me kërkesë të Komisionit Evropian. Megjithatë, në bazë korrespondencës së RrGK-së me ZKM-në, departamentet për Integritim Evropian, RrGK mësoi se takimi konsultativ nuk ishte mbajtur, sepse në të morën pjesë vetëm dy përfaqësues të OSHC-ve. Komiteti i Stabilizim Asociimit (Komiteti) është një strukturë që funksionon në nivelin më të lartë të menaxhimit të shërbimit civil (ndërmjet Këshillit të MSA-së në nivel politik dhe nënkomiteteve të nivelit sektorial si dhe

¹³ Qeveria e Republikës së Kosovës, [Rregullore \(QRK\) nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin konsultimit publik](#).

¹⁴ Korrespondenca e RrGK-së me ZKM-në, Departamentet për Integritim Evropian, nëntor 2023.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ ZKM, [“Integritimi Evropian”](#).

grupeve të veçanta), e cila mbështet Këshillin e MSA-së në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tija në zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve me qëllim për të siguruar dhe mbikëqyrur zbatimin e MSA-së.¹⁷ Në takimet e Komitetit të MSA-së diskutohen të gjithë kapitujt e mbuluar nga të gjitha nënkomitetet dhe grupet e veçanta, duke përfshirë atë për Politikën Sociale dhe Punësimin si dhe atë për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë, ku zakonisht përfshihet një perspektivë më e thelluar gjinore. Kryesisht, kur çështjet e barazisë gjinore u përfshinë në agjenda, ato prireshin të pasqyroheshin edhe në përfundime. Takimet e tjera të MSA-së dhe NK-së nuk përfshinin perspektivën gjinore, edhe pse mund ta kishin përfshirë atë. Për shembull, përfundimet nga takimi i NK të MSA-së për Ekonominë, Statistikat dhe Kontrollin Financiar sugjeruan se nuk kishte diskutim në lidhje me institucionalizimin e statistikave gjinore ose buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, sipas LBGJ. Kjo përkundër rekomandimeve të RrGK-së të dërguara për të informuar këtë proces, përmes të cilave kërkohej përmirësimi i konceptit dokumentit të ri për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe progresin drejt institucionalizimit të tij.¹⁸ Më tej, PKZMSA 2022-2026 parashikonte institucionalizimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, duke theksuar se: “Organet përgjegjëse të Kuvendit do të sigurojnë një mbikëqyrje të fortë mbi shpenzimin e buxhetit të parlamentit gjatë vitit financiar, duke përfshirë analizën, zbatimin dhe monitorimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor”.¹⁹

Si përmbledhje, konsultimet e BE-së dhe qeverisë me OSHC-të, përfshirë OSHCG-të, janë përmirësuar në krahasim me vitet e mëparshme, por gjetjet nga analiza e këtij viti të procesit të konsultimit të strukturave të MSA-së kanë mbetur afërsisht të njëjta si në vitin 2021.

Nevojiten strategji dhe përpjekje të mëtejshme për të siguruar pjesëmarrjen e më shumë OSHC-ve të ndryshme në konsultime, si dhe për të siguruar që aspekti i barazisë gjinore të përfshihet në të gjitha MSA-të dhe në agjendat dhe përfundimet nga takimet e NK të MSA-së.

Për më tepër, gjatë vitit 2022, RrGK ka ofruar kontributin e saj me gojë dhe me shkrim lidhur me takimet e mëposhtme të MSA-së:

- Kontributin për NK të MSA-së për Transportin, Mjedisin, Energjinë dhe Zhvillimin Rajonal – Takimi konsultativ me Shoqërinë Civile;
- Kontributin për takimin e VI të Komitetit të MSA-së;
- Kontributin për NK të MSA-së për Inovacionin, Politikën Sociale dhe Punësimin – Takimi konsultativ me Shoqërinë Civile;
- Kontributin për NK të MSA-së për Drejtësi, Liri dhe Siguri - Takimi konsultativ me Shoqërinë Civile; dhe
- Kontributin për Konsultimet me Shoqërinë Civile përpara Dialogut për Politikën e Menaxhimit të Financave Publike dhe Takimit të Nënkomitetit të MSA-së për Ekonomi, Financa dhe Statistikë.

C. EKZISTON ANGAZHIMI STRATEGJIK I BE-SË NË NIVEL VENDI PËR BARAZINË GJINORE

Ky kriter shqyrton angazhimin strategjik të BE-së në nivel vendi lidhur me barazinë gjinore. Treguesit e përdorur janë zotime dhe tregues të marrë drejtpërdrejt nga PVGJ III I BE-së (shih Tabelën C), duke përfshirë zotimet e BE-së ndaj Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB),²⁰ në kuadër të PVGJ III. Rezoluta KSKB 1325 dhe rezolutat simotra të saj janë të një rëndësie të veçantë për Kosovën, duke pasur parasysh se Kosova është

¹⁷ ZKM, “Integrimi Evropian”, “[Komiteti i Stabilizim-Asociimit](#)”.

¹⁸ ZKM, Agjencia për Barazi Gjinore, [Koncept-dokumenti mbi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor](#), 2022.

¹⁹ ZKM, [Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2022-2026](#), “Organet përgjegjëse të Kuvendit do të sigurojnë një mbikëqyrje të fortë mbi shpenzimin e buxhetit të parlamentit gjatë vitit financiar, duke përfshirë analizën, zbatimin dhe monitorimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor”, f. 20.

²⁰ Kombet e Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, [Rezoluta 1325 \(2000\)](#), e miratuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e tij të 4213-të, më 31 tetor 2000.

një vend i pas konfliktit dhe se proceset e paqes, përfshirë edhe dialogun zyrtar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, vazhdojnë të udhëhiqen nga BE. Sipas zotimeve të BE-së, BE-ja ka përgjegjësinë për të siguruar angazhimin e grave në këto procese.²¹

Tabela C. Deri në çfarë masë ekziston Angazhimi Strategjik i BE-së në nivel vendi për barazinë gjinore?	2021	2022	Ndryshimi
13. Plani i Zbatimit në nivel vendi (CLIP) për PVGj III u miratua dhe u përcoll në Selinë Qendrore në Bruksel (Treguesi i PVGj III 5.1)	Po	Po	1
14. Profili i shtetit gjinor është kryer ose i përditësuar	Po	Po	1
15. Analiza e plotë gjinore është kryer ose e përditësuar	Po	Po	1
16. Numri i analizave gjinore specifike për sektorët për fushat prioritare në ciklin e programit 2021-2027 është bërë dhe transmetuar në SQ (Bruksel) (Treguesi i PVGj III 5.2)	0	2	0.5
17. Niveli i ²² angazhimit të ZBE në dialog për barazinë gjinore me qeveritë, mekanizmat kombëtarë për barazi gjinore, parlamentet dhe akterët e tjerë institucionalë (Treguesi i PVGj III 7.1)	Mesatarisht	Mesatarisht	0.5
18. Deri në çfarë mase ZBE u konsultua me shoqërinë civile duke përfshirë OSHCG për zhvillimin e CLIP	Plotësisht	Plotësisht	1
19. Deri në çfarë mase angazhohet ZBE në dialog për barazinë gjinore me shoqërinë civile, duke përfshirë edhe OSHCG –të (Treguesi i PVGj III 7.2) ²³	Mesatarisht	Mesatarisht	0.5
20. Deri në çfarë mase angazhohet ZBE në dialog me shoqërinë civile për çështjet e grave, paqes dhe sigurisë në vendet partnere (Treguesi i PVGj III 7.2)	Minimalisht	Minimalisht	0

Siç u theksua në Raportin e mëparshëm të Monitorimit 2021, ZBEK ka kompletuar [Planin e Zbatimit në nivel vendi \(CLIP\) për Kosovën](#), përmes një procesi tejet konsultativ në vitin 2021. Procesi i Kosovës ishte mjaft unik në krahasim me vendet e tjera sepse ZBEK angazhoi RrGK-në, si rrjet udhëheqës i OSHCG-ve me ekspertizë, për të zhvilluar CLIP-in si pjesë e kontratës ekzistuese për shërbime që e ka me ZBEK-un. Me mbështetje nga RrGK-ja, BE-ja ka organizuar disa konsultime me grupe të ndryshme të palëve të interesuara (p.sh. shoqërinë civile, qeverinë, agjencitë e KB-së, shtetet anëtare të BE-së dhe anëtarët e stafit të BE-së) për të mbledhur kontributin e tyre për CLIP. Konsultimet e shoqërisë civile u organizuan së bashku me Asistencën Teknike të BE-së për Organizatat e Shoqërisë Civile (EU TACSO), që janë reklamuar gjerësisht përmes rrjeteve të OSHCG-ve dhe ishin të hapura për të gjithë anëtarët e shoqërisë civile të interesuara që të marrin pjesë. Ky proces konsultativ siguroi që CLIP të bazohej në analizën gjinore, nevojat dhe kontributin nga OSHCG-të e ndryshme, mes palëve të tjera të interesuara.²⁴ CLIP u miratua nga ZBEK, u transmetua në Bruksel dhe u publikua. Me sa duket deri tani, asnjë rishikim nuk është bërë në CLIP e as nuk duket se janë bërë konsultime për zbatimin e tij.

Kosova tashmë ka profilin gjinor të vendit [Analizën Gjinore të Kosovës](#), e cila është hulumtuar dhe shkruar nga RrGK-ja për ZBEK, dhe është publikuar në vitin 2018. Duke pasur parasysh kërkesën që të jetë më pak se pesë vjeç, ZBEK dhe RrGK përcaktuan se kjo periudhë ishte e mjaftueshme për informimin e përmbytjes së CLIP, megjithëse një analizë e re pritet të kryhet në vitin 2024. Për të siguruar me kohë të dhënat që kanë të bëjnë me treguesit e PVGj III

²¹ Këshilli i Bashkimit Evropian, [Gratë, Paqja dhe Siguria – përfundimet nga Këshilli](#), 10 dhjetor 2018.

²² Në çfarë mase/Sa?/Shkalla.. (nga anglishtja: *Extent*) është përdorur dhe përkufizuar si numri i herëve në vit që BE-ja takohet me OSHCG-të për të diskutuar çështjet e barazisë gjinore. Dialogu është përkufizuar dhe përdorur që të përfshinte diskutime për çështje të ndryshme politike (jo vetëm “çështjet e grave”).

²³ Në çfarë mase/Sa?/Shkalla.. (nga anglishtja: *Extent*) është përdorur dhe përkufizuar si numri i herëve në vit që BE-ja takohet me OSHCG-të për të diskutuar çështjet e barazisë gjinore. Dialogu është përkufizuar dhe përdorur që të përfshinte diskutime për çështje të ndryshme politike (jo vetëm “çështjet e grave”).

²⁴ Në forume dhe takime të ndryshme, ZBEK, KE, dhe OSHCG të ndryshme shprehën kënaqësinë e tyre me procesin gjithëpërfshirës dhe konsultativ.

relevant për Kosovën, RrGK gjithashtu ka kryer një [përditësim të përsheptuar](#) të analizës në vitin 2021, e cila ka informuar procesin e hartimit të CLIP. *Analiza Gjinore e Kosovës* dhe përditësimi i përsheptuar i saj përmbajnë analizën gjinore specifike për sektorët për pothuajse të gjitha fushat prioritare të identifikuar për ciklin e hartimit të programeve të BE-së për 2021-2027. Prandaj, disa analiza gjinore specifike për sektorë ekzistojnë për tetë sektorë, të përditësuar në vitin 2021 për të informuar përmbajtjen e CLIP. Sa i përket analizave gjithëpërfshirëse gjinore dhe specifike për sektorë, në vitin 2022, BE-ja ka mbështetur sa vijon: 1) analizën gjinore në lidhje me reformën e financave publike, duke përdorur Kornizën Shtesë të Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjësiwe Financiare (PEFA) për Vlerësimin e Menaxhimit të Financave Publike të Përgjegjshme Gjinore;²⁵ 2) Botimin e dytë të raportit hulumtues të RrGK-së *Diskriminimi me bazë gjinore në vendin e punës në Kosovë*, të bashkëfinancuar nga BE-ja dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida);²⁶ dhe 3) Analizën gjinore të RrGK-së për digjitalizimin, të bashkëfinancuar gjithashtu nga BE-ja dhe Sida, e cila ende nuk është publikuar dhe për këtë arsye për të nuk raportohet këtu.

ZBEK/PSBE u angazhua në dialog për barazinë gjinore me qeveritë, mekanizmat kombëtarë për barazi gjinore (MKBGJ), parlamentet dhe akterë të tjerë institucionalë në masë mesatare. Gjatë vitit 2022, ky ndërlidhej me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në qeveri dhe institucionet e tjera. Përveç takimeve të sipërpërmendura të MSA-së, ky dialog nuk ka qenë i strukturuar, por ka ndodhur përmes ngjarjeve të ndryshme ku ZBEK/PSBE përmendi barazinë gjinore si vlerë themelore të BE-së, ndër çështje të tjera.²⁷

Sa i përket angazhimit me MKBGJ, ZBEK/PSBE dhe EULEX, veçanërisht këshilltarët për çështje gjinore, angazhoheshin periodikisht me Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ) në ZKM. Megjithatë, si në vitin 2021, edhe në vitin 2022, BE-ja nuk u angazhua me ABGJ-në në dialog zyrtar politik,²⁸ në lidhje me sektorë të ndryshëm në të cilët ABGJ mund të kishte ofruar ekspertizë gjinore në kuptimin dhe përmirësimin e vëmendjes ndaj barazisë gjinore.

EULEX-i ka raportuar se ka diskutuar për barazinë gjinore në çdo takim që EULEX-i ka me Presidencën dhe institucionet qeveritare.²⁹ Këto takime zhvillohen në bazë të rregullt dhe atë mujore. EULEX-i është gjithashtu pjesë e Grupit Punues Ndërmindor kundër dhunës në familje dhe ishte pjesë e procesit të hartimit të Ligjit të miratuar së fundmi për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën me Bazë Gjinore. Misioni i EULEX-it gjithashtu ka mbështetur Grupin Punues që ka hartuar Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale.³⁰ Homologët kryesorë të BE-së sa i përket barazisë gjinore mbeten Grupi i Grave Deputete dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Zhdukur dhe Peticionet. Në mënyrë të ngjashme, dialogu i EULEX-it me parlamentin në dukje vazhdoi të lidhej me përputhshmërinë e draft legjislacionit kombëtar me parimet e barazisë gjinore, veçanërisht lidhur me dhunën me bazë gjinore.

ZBEK/PSBE ka pasur angazhim të moderuar në dialogun mbi barazinë gjinore me shoqërinë civile, duke përfshirë OSHCG-të. Në vitin 2022 nuk u organizua asnjë takim i strukturuar apo i rregullt.³¹ Megjithatë, OSHCG-të u takuan me Këshilltarin për Çështje Gjinore të ZBE-së dhe shpesh dhanë kontributin e tyre lidhur me zhvillimet politike ose legjislative. Më tej, Ambasadori i BE-së Tomáš Szunyog u takua me OSHCG-të, përfshirë edhe një herë me RrGK-në, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas si dhe u takua me aktivistë të shoqërisë civile, duke përfshirë

²⁵ [Kosovë: Raporti i Vlerësimit të Performancës lidhur llogaridhënen për shpenzimet dhe financat publike \(PEFA\)](#), 17 shkurt 2022.

²⁶ RrGK, [Diskriminimi me bazë gjinore në vend të punës në Kosovë](#), 2022. RrGK gjithashtu udhëhoqi hulumtimin rajonal për të njëjtën temë, por ai nuk përmendet këtu pasi u referohet gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Vlen të theksohet se është bërë një Analizë Gjinore mbi bujqësinë po ashtu nga RrGK-a, e mbështetur nga Organizata e OKB-së për Ushqim dhe Bujqësi (FAO) dhe do të publikohet në vitin 2023; BE-ja është konsultuar në këtë proces dhe mund ta përdorë këtë analizë.

²⁷ RrGK, përgjigjet ndaj kërkesës për të dhëna nga ZBEK, 2022.

²⁸ Po aty.

²⁹ RrGK, përgjigjet ndaj kërkesës për të dhëna nga EULEX, 2022.

³⁰ Po aty.

³¹ RrGK, përgjigjet ndaj kërkesës për të dhëna nga ZBEK, 2022.

RrGK-në në Ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë. Takimi i vetëm i strukturuar, ndonëse i parregullt, ndërmjet Ambasadorit të BE-së dhe Këshilltarit të BE-së për Çështjet Gjinore me OSHCG-të u mbajt në nëntor 2022 me OSHCG që përfaqësojnë grupet *grassroot* (të komunitetit lokal) dhe ato të cënueshme, Organizatat anëtare të RrGK-së, duke përfshirë: Qendrën për Edukim dhe Zhvillim të Komunitetit – Friends, Rrjetin e Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të Kosovës, Organizatën e Personave me Distrofi Muskulare të Kosovës, Qendrën Kosovare për Studime Gjinore dhe organizatën Ruka Ruci. Disa nga çështjet e diskutuara gjatë këtij takimi ishin:

- Vështirësitë me të cilat ballafaqohen OSHCG-të në qasjen dhe sigurimin e fondeve të qëndrueshme;
- Pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje, duke përfshirë pjesëmarrjen në parlament, kuvendet komunale, në nivel lokal dhe atë kombëtar dhe në administratën publike;
- Prevalenca e dhunës me bazë gjinore, nevoja për financim më të mirë të ofruesve të shërbimeve dhe trajnimit i ofruesve të shërbimeve sociale;
- Përmasat e diskriminimit ndaj grave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian; dhe
- Siguria e OSHCG-ve kosovare dhe serbe që punojnë në ndërtimin e paqes në Mitrovicën Jugore dhe Veriore.

Ky takim u bashkëorganizua nga ZBE dhe RrGK në kuadër të projektit “Fuqizimi i Pjesëmarrjes së Grave në Politikë” të mbështetur nga BE-ja, me qëllim të nxitjes së marrëdhënieve dhe dialogut më të mirë ndërmjet OSHCG-ve dhe ZBE-së në Kosovë.

Misioni i EULEX-it merr pjesë rregullisht në ngjarjet e organizuara nga shoqëria civile që kanë të bëjnë me barazinë gjinore.³² Përfaqësuesit e misionit takohen rregullisht me OSHCG-të, përfshirë OSHCG-të, si dhe me ato organizata që përfaqësojnë personat LGBTQI+, personat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët.³³ Misioni gjithashtu angazhon shoqërinë civile si partnerë në zbatim. Misioni, veçanërisht Këshilltari për Çështje, takohet rregullisht me OSHCG-të për qëllime rrjetëzimi, aktivitete të përbashkëta dhe për të diskutuar çështje me interes të përbashkët.³⁴

Përveç pjesëmarrjes së përbashkët në Forumin Ndërkombëtar të Kosovës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë të organizuar nga Presidentja e Kosovës në vitin 2022, dialogu i BE-së me shoqërinë civile për çështjet e grave, paqes dhe sigurisë, mbeti i dobët, duke pasur parasysh se Kosova është një vend i pas konfliktit ku BE-ja duhet të ndërmarrë dhe të bëjë konsultime të rregullta me OSHCG-të sipas Rezolutës 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, [Qasjes strategjike të BE-së ndaj grave, paqes dhe sigurisë](#)³⁵ dhe zotimeve të harmonizuara të PVGj III. Dialogu Prishtinë-Beograd vazhdoi gjatë gjithë vitit 2022 për qëllime të arritjes së një zgjidhjeje të qëndrueshme dhe paqësore të konfliktit të vazhdueshëm. Disa tensione politike ndodhën në Mitrovicën Veriore në shtator-tetor 2022. Megjithatë, kontributi i OSHCG-ve që punonin në atë zonë si nga Mitrovica Veriore edhe nga Mitrovica Jugore ishte praktikisht i padukshëm.³⁶ Më tej, puna e OSHCG-ve për shumë dekada me qëllim të pajtimit dhe paqes vazhdon të jetë në rrezik, për shkak të ndërhyrjeve të vazhdueshme politike që kufizojnë aktivizmin e tyre. Përfaqësuesi Special i BE-së për Dialogun Beograd-Prishtinë, Miroslav Lajčák, ka bërë disa vizita në Kosovë lidhur me këtë proces. Ai dhe ekipi i tij nuk takuan kurrë OSHCG-të për t'i përfshirë ato në këto procese, për të diskutuar për prioritetet e grave ose për të siguruar vëmendjen ndaj barazisë gjinore si pjesë e këtij procesi. RrGK e ngriti këtë çështje me BE-në gjatë vizitave të avokimit në Bruksel dhe kërkoi përmirësim të konsultimeve dhe angazhim më të madh të grave në procesin e dialogut. Gratë dhe

³² RrGK, përgjigjet ndaj kërkesës për të dhëna nga EULEX, 2022.

³³ Po aty.

³⁴ Po aty.

³⁵ EEAS, [Qasje strategjike e BE-së ndaj grave, paqes dhe sigurisë](#), Shtojcë, nëntor 2018, f. 6.

³⁶ Korrespondenca e RrGK-së me OSHCG-të që punojnë në Mitrovicën Jugore dhe Veriore.

prioritetet e tyre përgjithësisht janë lënë jashtë këtij procesi të paqes, duke penguar kështu vendosjen e një paqeje gjithëpërfshirëse, të përgjegjshme gjinore dhe të qëndrueshme.³⁷

D. BE-ja PËRFSHIN PERSPEKTIVËN GJINORE NË TË GJITHA INICIATIVAT DHE NË ATO TË SYNUARA

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, Komiteti i Asistencës për Zhvillim (KAZH OBZHE) ka vendosur kritere specifike për shënuesit gjinorë për programet. Ky kriter shqyrton se sa BE-ja e ka integruar perspektivën gjinore në të gjitha iniciativat e saj (*Action Documents*), bazuar në kriteret e përcaktuara, si dhe nëse BE-ja ka planifikuar iniciativat të synuara me qëllim të avancimit të barazisë gjinore, siç parashihet në PVGj III. Afati kohor i referohet iniciativave të zhvilluara në vitin 2022.

Tabela D. Shkalla në të cilën BE-ja përfshin perspektivën gjinore në të gjitha iniciativat dhe në ato të synuara	2021	2022	Ndryshimi
21. Numri dhe % e iniciativave të reja ³⁸ që janë të përgjegjshme ndaj gjinisë ose me ndikim specifik gjinor (GM1 + GM2) në nivel vendi (PVGj III, treguesi 1.1)	7 (100%) ³⁹	4 (100%)	1
22. Numri dhe % e iniciativave të reja me ndikim specifik gjinor (GM2), të zbatuara në kuadër të fondeve të alokuara nga BE në nivel vendi (PVGj III, treguesi 1.2)	0 (0%)	0 (0%)	0
23. Shuma totale e financimit për avancimin e barazisë gjinore në nivel vendi (GM1 + GM2) (PVGj III, treguesi 1.3)	71.21 € milion ⁴⁰	62.25 € milion	-0.5
24. Shuma e financimit në mbështetje të organizatave të grave në nivel vendi (PVGj III, treguesi 1.4)	488,300 €	0 €	-1
25. % e iniciativave të reja që mbështesin reformat në menaxhimin e financave publike të cilat kanë përfshirë një komponent gjinor (PVGj III, treguesi 3.1)	100%	N/A	0

Të katër iniciativat e reja të BE-së të miratuara në vitin 2022 u shënuan me Shënuesin Gjinor (GM) 1. BE-ja nuk ka ende një sistem për përcjelljen/gjurmimin e financimit total në mbështetje të barazisë gjinore në mënyrë specifike. Siç u cek, BE-ja përdorur shënjesin gjinor të standardizuar të OBZHE dhe kjo mund të kontribuojë në një keqinterpretim të burimeve faktikisht të alokuara duke pasur parasysh natyrën e kësaj metodologjie të OBZHE. Është për t'u theksuar se në GM1, vetëm një përqindje e caktuar fondeve kontribuon në barazinë gjinore; fondet tjera mund të përdoren për qëllime të tjera [pasiqë në këto të fundit, gjinia nuk është objektive specifike]. Megjithatë, nuk ekziston asnjë mënyrë për të vlerësuar sasinë e saktë të fondeve të shpenzuara për barazinë gjinore në veprimet GM1. Prandaj, sipas treguesit 1.3 të PVGj III, BE-ja mund të arrijë vetëm në vlerësim të përafërt të shumës së përgjithshme të financimit që do të kontribuojë në barazinë gjinore. Në Kosovë, kjo ishte rreth 62.25 milionë € në vitin 2022, që është edhe shumën e përgjithshme të paraparë, pasi që të katër dokumentet e veprimit ishin shënuar me GM1.⁴¹ Megjithatë, RrGK vlerësoi se shënjesi gjinor i caktuar për DV-të nuk ishte gjithmonë i saktë (shih Tabelën 1), pasi ato nuk i përmbushnin të gjitha kriteret e KAZH të OBZHE

³⁷ Shih: RrGK, [Një ulëse në tryezë](#): Kontributet e grave në proceset e ndërtimit të paqes në Kosovë dhe pritjet nga këto procese, 2021.

³⁸ Kjo i referohet Dokumenteve të Veprimit dhe jo kontratave. "Të reja" u referohet atyre të miratuara në vitin 2022.

³⁹ Ky numër është ndryshuar që nga raporti i monitorimit që u publikua në vitin 2021 për arsye se BE-ja kishte publikuar [Dokumentin e Veprimit mbi Programin për Shoqërinë Civile dhe Mediat në Kosovë* 2021-2023](#) pas ishte publikuar raporti i monitorimit. Kjo është ndryshuar për të reflektuar këtë Dokument të Veprimit, të miratuar në vitin 2021.

⁴⁰ Po aty; ky numër është ndryshuar që nga raporti i monitorimit që u publikua në vitin 2021.

⁴¹ KE, Bruksel, [Vendimi përfundimtar i Komisionit Zbatues](#), i datës 30.11.2022 për financimin e planit vjetor të veprimit në favor të Kosovës për vitin 2022, neni 2, Kontributi i Bashkimit Evropian.

për t'u shënuar si GM1. Megjithatë DV-të përmbajnë disa analiza gjinore, jo të gjitha objektivat dhe pikënisjet matin ndryshimet në barazinë gjinore sipas kritereve të OBZHE-së. Prandaj, shumat e financimit të dedikuar për barazinë gjinore është me sa duket më e ulët. Për më tepër, padyshim që 100% e financimit të BE-së nuk do të shkojë për avancimin e barazisë gjinore në veprimet GM1, por ky është një problem me metodologjinë e OBZHE-së dhe rrjedhimisht me vetë treguesin PVGj III.

BE nuk ka asnjë mënyrë për të matur financimin për OSHCG-të dhe lëvizjet. përmes sistemeve të saj ekzistuese. Edhe pse ZBEK kishte kontrata të vazhdueshme të nënshkruara në vitet e mëparshme me OSHCG-të që mbështetën OSHCG-të në vitin 2022, këto nuk janë përfshirë këtu bazuar në metodologjinë, e cila pasqyron vetëm kontratat e nënshkruara në vitin 2022. Asnjë kontratë e re nuk u nënshkrua me OSHCG-të në vitin 2022.

BE poasht nuk ka nënshkruar ndonjë kontratë të re në lidhje me reformën e financave publike këtë vit. Megjithatë, ZBEK vazhdon të ofrojë Asistencë Teknike për të mbështetur reformat për Menaxhimin e Financave Publike (MFP) në Kosovë që zbatohen nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ). Kjo përfshinte vlerësimin e lartpërmendur sipas Kornizës Shtesë të PEFA-s për Vlerësimin e Menaxhimit të Financave Publike të Përgjegjshme Gjinore, të bërë në vitin 2021 dhe të publikuar në vitin 2022.⁴² Kjo analizë gjinore, e bazuar në një metodologji të respektuar, ka krijuar një bazë, duke identifikuar hapat e ardhshëm të nevojshëm për të mbështetur avancimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Kosovë bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare.

E. BE-ja UDHEHEQ SI SHEMBULL

Ky kriter shqyrton se në çfarë mase BE-ja po udhëheq si shembull, duke vendosur udhëheqje të përgjegjshme dhe të balancuar gjinore në nivelet më të larta politike dhe menaxhuese të BE-së, sipas PVGj III, shtylla 4. Poashtu, diskuton udhëheqjen e ZBEK dhe EULEX-it, si mision i Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP).

Tabela E. Deri në çfarë mase BE-ja udhëheqë si shembull?	2021	2022	Ndryshimi
26. Numri dhe % e grave në pozita menaxheriale në Zyrën e BE-së, PSBE, EULEX, dhe CSDP-së (PVGj III, treguesi 10.1) ⁴³	0 ⁴⁴	0%	0
27. % e stafit menaxhues të trajnuar për barazinë gjinore dhe PVGj III në Zyrën e BE-së dhe CSDP (treguesi 10.2)	92%	0%	-0.5
28. % e stafit menaxhues të trajnuar për agjendën e Grave, Paqen dhe Sigurinë në Zyrën e BE-së dhe CSDP (treguesi 10.2)	14%	0%	-0.5
29. Numri i Këshilltarëve Gjinor / Pikave Gjinore të Kontaktit në Zyrën e BE-së dhe CSDP	14	13	-0.5

Sipas përkufizimit të pozitive menaxhuese të KE-së, në pozitat e larta menaxhuese konsiderohen të jenë Shefat e Delegacioneve, ndërsa në pozitat e menaxhimit të mesëm konsiderohen të jenë Shefat për Bashkëpunim.⁴⁵ Që nga shkurti 2022, në ZBEK, Shefi i Misionit ishte burrë. Ndërkohë, dy nga gjashtë shefa të departamenteve ishin gra (29%). Në ZBEK,

⁴² [Kosovë: Raport i vlerësimit të performancës lidhur me llogaridhënien për shpenzimet dhe financat publike \(PEFA\)](#), 17 shkurt 2022.

⁴³ Stafi menaxhues i lartë është përcaktuar të përfshijë: Sekretarët e Përgjithshëm, Zëvendës Sekretarët e Përgjithshëm, Drejtorët Menaxhues, Drejtorët dhe disa Ambasadorë (në nivel Drejtorësh. Në stafin menaxhues të mesëm hynë Shefat e departamenteve dhe shumica e Ambasadorëve. Në praktikë, brenda një misioni të caktuar si Kosova, pozita shtesë mund të marrin pjesë në takimet e menaxhmentit, por ky tregues i referohet vetëm këtij përkufizimi.

⁴⁴ Ky indikator është rishikuar në krahasim me raportin e vitit 2021 pas sqarimit të definicionit mbi kuptimin e "menaxhmentit të lartë."

⁴⁵ KE, [Menaxherët në Komisionin Evropian](#), "Përshkrimet e vendeve të punës, kualifikimet kryesore dhe vendet e lira të punës për pozicione menaxhuese në Komisionin Evropian".

PSBE/Ambasadori është burrë, dhe një nga katër shefat e departamenteve është grua (20%). Në EULEX, si shefi i misionit ashtu edhe zëvendës shefi i misionit janë burra.

RrGK ofroi katër trajnime për 43 persona, staf të BE-së, duke përfshirë dy trajnime bazë për barazinë gjinore, një për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe një për aspektin gjinor në sektorin e drejtësisë dhe sundimit të ligjit. Edhe pse në njërin trajnim mori pjesë Zëvendës Shefi i Misionit të ZBEK-ut, asnjë nuk u ndoq nga menaxhmenti i lartë apo i mesëm në vitin 2022. Megjithatë, ata kanë marrë pjesë në trajnime të tilla në vitet e mëparshme. RrGK gjithashtu ofroi mentorim të vazhdueshëm për stafin e ZBEK-së mbi përfshirjen e perspektivës gjinore në dokumentet e veprimit të integritetit gjinor, kontratat dhe termat e referencës, përmes marrëveshjes që RrGK kishte me ZBEK deri në fund të vitit 2022. Kjo ka kontribuar në zbatimin e CLIP dhe PVGj III.⁴⁶ Njësoj, në EULEX, në vitin 2022, të gjithë menaxherët e rinj janë trajnuar për barazinë gjinore, PVGj III dhe gratë, paqen dhe sigurinë. Ndërkohë, të tjerë kanë marrë trajnime më parë, në vitin 2021.

Në Kosovë, BE-ja ka një këshilltar për çështje gjinore me orar të plotë dhe një pikë gjinore të kontaktit në ZBEK/PSBE, një këshilltar për çështje gjinore me orar të plotë në misionin CSDP të EULEX dhe 10 pika gjinore të kontaktit në EULEX, me gjithsej 13 persona. Përveç këshilltarit për çështje gjinore, i cili i raporton Shefit të Misionit të EULEX-it, asnjë nga pikat gjinore të kontaktit nuk janë në nivelin menaxherial ose raportojnë drejtpërdrejt te shefat e misionit. Kjo kufizon ndikimin e pikave gjinore të kontaktit në ZBEK. Ndërkohë, Pika gjinore e kontaktit e ZBEK-ut nuk i kishte këto përgjegjësi të përfshira qartë në përshkrimin e punës së saj, si Zyrtare e programeve horizontale të IPA-së. Kjo ishte për shkak se përgjegjësitë e pikës gjinore të kontaktit nuk ishin përfshirë në pozitën kur u shpall, dhe, për shkak të procedurave të BE-së, pozita do të duhej të rishpallej për t'i shtuar këto përgjegjësi në përshkrimin e punës së saj. Kjo është një sfidë administrative që ka penguar përfshirjen e këtyre përgjegjësive në punën e pikave gjinore të kontaktit. Duke pasur parasysh përgjegjësitë e tjera të saj, koha që ajo mund të shpenzonte si pikë gjinore e kontaktit ka qenë e kufizuar. Me konkursin e ri të punës është bërë përpjekje që të zgjidhet pjesërisht kjo çështje, por vendi i punës ende nuk është plotësuar. EULEX-i ka një këshilltar për çështje gjinore me orar të plotë me përshkrim të qartë të punës, dhe pikat gjinore të kontaktit në EULEX i kanë të qarta termat e referencës.

F. QEVERIA MIRATON LEGJISLACIONIN NË PËRPUTHJE ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE TË BE-SË PËR BARAZINË GJINORE DHE KONSULTON OSHCG-TË

Ky kriter shqyrton nivelin deri në të cilën qeveria ka miratuar legjislacionin në përputhje me Acquis Communautaire të BE-së për Barazinë Gjinore dhe konsultimin me OSHCG-të.

Tabela F. Masa në të cilën Qeveria miraton legjislacionin në përputhje me Acquis Communautaire të BE-së për Barazinë Gjinore dhe konsultimet me OSHCG-të	2021	2022	Ndryshimi
30. Niveli i trajtimit të barazisë gjinore në Programin Kombëtar për Miratimi të Acquis	Gjerësisht	Gjerësisht	1
31. Niveli i konsultimit publik të ligjeve kyçe për barazinë gjinore dhe anëtarësimin në BE	Plotësisht	Plotësisht	1
32. Niveli i integritetit të rekomandimeve nga OSHCG-të në përputhje me Acquis të BE-së për barazinë gjinore	Minimalisht	Minimalisht	0
33. Niveli i publikimit të strategjive të reja sektoriale	Plotësisht	Plotësisht	1
34. Niveli i përfshirjes gjinore në strategjitë e reja sektoriale	Mesatar	Mesatar	0

⁴⁶ ZBEK, Plani i Veprimit Gjinor III – 2021-2025 [Plani i Zbatimit në nivel vendi për Kosovën](#), f. 6 Përfshirja e OSHC-ve.

35. % e grupeve të punës sektoriale (ose të ngjashme) me OSHCG-të të përfshira ose të përfaqësuara	E pa aplikueshme	E pa aplikueshme	E pa aplikueshme
--	------------------	------------------	------------------

Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) [2022-2026](#) është dokumenti kryesor strategjik kombëtar i Kosovës për zbatimin e Agjendës së Reformës Evropiane. Ai përcakton reformat e nevojshme për zbatimin e MSA-së dhe transpozimin e Acquis të BE-së në legjislacionin kombëtar. Kosova miratoi PKZMSA 2021-2025 në tetor të vitit 2021, dokument ky i cili përditësohet çdo vit. Qeveria mban konsultime publike çdo vit gjatë procesit të përditësimit të PKZMSA për ta harmonizuar atë me Programin e Qeverisë 2021-2025, Planet Operacionale Strategjike (POS) të ZKM-së dhe ministrive, dhe Planin e Veprimit II Agjenda e Reformës Evropiane (ARE). PKZMSA 2022-2026 përmban afërsisht 75% të rekomandimeve të RrGK. Si PKZMSA-ja e shtatë në të cilën RrGK ka komentuar që nga viti 2016, RrGK e vlerëson se është dokumenti me nivelin më të lartë të përfshirjes gjinore ndër vite, pasi vëmendja ndaj gjinisë është e përfshirë në kapituj të ndryshëm, duke përfshirë kapituj në të cilët më parë nuk kishte gjasa të përfshihej, si Demokracia dhe Zgjedhjet, Energjia, Financa/E drejta e Kompanive, Reforma në Administratën Publike, Industria, Ekonomia, Qeverisja Vendore dhe Standardet Evropiane, Të Drejtat Themelore dhe Gjyqësori. Perspektiva e përmirësuar gjinore në PKZMSA kryesisht rrodhi nga kontributi i përvitshëm i RrGK-së në të, pasi disa seksione ku gjinia ishte e përfshirë, u bazuan në rekomandimet e RrGK nga viti i kaluar, si dhe nga vitet e mëparshme. Për shkak të avokimit të RrGK-së dhe anëtarëve të saj, PKZMSA 2022-2026 gjithashtu deklaroi se forcat e sigurisë duhet të jenë plotësisht në përputhje me Rezolutën 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe se ndërtimi i një paqeje afatgjatë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe vendosja e Marrëdhënieve diplomatike dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore në frymën evropiane, kërkojnë përfshirjen dhe pjesëmarrjen e grave dhe burrave në proceset e dialogut. Në përmbledhje, PKZMSA përfshinë në masë të madhe gjininë. Këto ishin disa nga prioritetet afatmesme që përfshinte PKZMSA 2022-2026:

- Kriteret Politike, Parlamenti: “Organet përgjegjëse të Kuvendit do të sigurojnë një mbikëqyrje të fortë mbi shpenzimin e buxhetit të parlamentit gjatë vitit financiar, duke përfshirë analizën, zbatimin dhe monitorimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.”⁴⁷;
- Ligji për shoqëritë tregtare: “Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike të dyqaneve me një ndalesë dhe i shërbimeve të biznesit, përmirësimi i shërbimeve të biznesit dhe ndërmarrja e veprimeve afirmative për inkurajimin e gjinisë së nënpërfaqësuar, në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore”⁴⁸;
- Shërbimet financiare: “Sektori i pensioneve: Korniza rregullative e BQK-së në fushën e pensioneve [Banka Qendrore e Kosovës] do të ndryshohet në përputhje me kërkesat e Ligjit për fondet pensionale dhe acquis të BE-së në fushën e pensioneve. Me kërkesë të organizatave të shoqërisë civile që merren me barazinë gjinore, duhet të sigurohet integrimi gjinor në këtë proces, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore”;⁴⁹
- Kapaciteti për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Unionit:
- “Rritja e qasjes të të rinjve dhe grave në tregun e punës duke ofruar shërbime cilësore punësimi, masa aktive punësimi dhe sipërmarrje”;⁵⁰
- Efienca e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë: “Ndarja e granteve për masat e efikasitetit për bizneset në pronësi të grave në kuadër të “Zinxhirit të besueshëm të energjisë”;⁵¹

⁴⁷ PKZMSA 2022-2026, f. 19.

⁴⁸ Po aty., f. 95.

⁴⁹ Po aty., f. 118.

⁵⁰ Po aty., f. 68.

⁵¹ Po aty., f. 145.

- Politika ekonomike: “Mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme duke rritur fondin e garancisë së kredisë dhe lehtësira të tjera administrative, duke përfshirë, ndër të tjera, ndërmarrjen e masave afirmative për sipërmarrjet e drejtuara nga gratë”⁵²;
- Politika Sociale dhe Punësimi: “Ligji i ri për Shërbimet Sociale dhe Familjare që do të mundësoj avancimin e shërbimeve sociale, do të forcoj qendrat për punë sociale në nivel lokal, do të përcaktoj procedurat e licencimit dhe kornizën e funksionimit të ofruesve të shërbimeve sociale nga sektori joqeveritar dhe privat.”⁵³;
- Të drejtat themelore: “Fuqizimi i rolit të zyrtarëve për barazi gjinore në ministri dhe komuna; Forcimi i rolit të grave dhe vajzave në procesin e vendimmarrjes, fuqizimi i tyre ekonomik dhe eliminimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje; Përafrimi i legjislacionit të reformës zgjedhore me Ligjin për Barazinë Gjinore; Zbatimi i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe krijimi i një sistemi monitorues për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore; Miratimi i Strategjisë së re kundër dhunës në familje; Zbatimi i Vlerësimit të Ndikimit Gjinator për kuadrin rregullator; Të hetohen plotësisht sulmet ndaj gazetarëve, rastet e dhunës seksuale dhe në familje, krimet e urrejtjes, gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit, dhe sulmet ndaj personave LGBTI, duke siguruar hetime dhe gjykime në kohë dhe të plota; Të ndërmerren veprime konkrete për të siguruar funksionimin e strehimoreve për viktimat e dhunës me bazë gjinore.”⁵⁴;
- Gjyqësori: “Procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të mbetur të [Këshillit Gjyqësor të Kosovës] KGJK dhe [Këshillit Prokurorial të Kosovës] KPK duhet të jetë [...] transparent, i bazuar në merita, duke respektuar balancën në bazë të pakicave dhe gjinisë.”⁵⁵

Mes raportimit mbi gjendjen aktuale ose renditjes së sfidave apo prioriteteve afatmesme në lidhje me kapituj të ndryshëm të Acquis, Qeveria shpesh kishte përdorur shprehjen: “Sipas gjetjeve të OSHC-ve” ose “Me kërkesë të organizatave të shoqërisë civile”. Edhe pse njohja e kërkesave të OSHCG-ve për integrimin gjinor në këtë dokument është e mirëseardhur, RrGK vëren se Qeveria duhet të zëvendësojë shprehjen “Me kërkesë të OSHC-ve” dhe të ju referohet në fakt kërkesave ligjore, që kërkojnë integrimin gjinor në politika publike. Për shembull, në lidhje me të drejtën e regjistrimit të pronës përmes sistemit kadastral, PKZMSA 2022-2026 thekson se “Me kërkesë të organizatave të shoqërisë civile që merren me barazinë gjinore, kjo rregullore duhet të siguroj që të gjitha të dhënat e sistemit kadastral të jenë të ndara sipas gjinisë.”⁵⁶ Megjithatë, të dhënat e ndara sipas gjinisë janë një kërkesë e drejtpërdrejtë e NPV-së, neni 5.

Ligjet dhe politikat publike vihen gjithmonë në dispozicion për konsultime publike. Që nga viti 2016, ky është obligim i Qeverisë sipas [Rregullores \(GRK\) Nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik](#). Më tej, Kosova ka [platformë për konsultime publike](#), përmes së cilës si OSHC-të ashtu edhe gratë dhe burrat individualisht mund të ngarkojnë të dhënat e tyre për draft politikat ose t’u dërgojnë të dhëna drejtpërdrejt zyrtarëve përgjegjës në ministritë e linjës. RrGK së bashku me OSHCG-të anëtare të saj përdorin rregullisht platformën e konsultimit publik për të propozuar mënyra specifike për përmirësimin e vëmendjes ndaj barazisë gjinore brenda projektligjeve, rregulloreve dhe dokumenteve. Qeveria gjithashtu publikon në të njëjtën platformë dokumente të rëndësishme për procesin e anëtarësimit në BE dhe strategjitë e reja sektoriale. Prandaj, të gjitha këto dokumente janë të disponueshme publikisht. Megjithatë, më shumë kohë mund të sigurohet për konsultime publike, veçanërisht për dokumente më të gjata si PKZMSA.

ABGJ gjithashtu monitoron politikat publike dhe shpesh konsultohet për të përfshirë një perspektivë gjinore në disa prej tyre, edhe pse jo në të gjitha. Burimet njerëzore të pamjaftueshme

⁵² Po aty., f. 158.

⁵³ Po aty., f. 169.

⁵⁴ Po aty., f. 194.

⁵⁵ Po aty., f. 182.

⁵⁶ Po aty., f. 51.

e bëjnë të vështirë për ABGJ të monitoroj shkallën në të cilën kontributet dhe rekomandimet e saj janë përfshirë në të gjitha ligjet dhe strategjitë e miratuara.⁵⁷

Ndërkohë, kontributi i OSHCG-ve në përputhje me Acquis të BE-së për barazinë gjinore është përfshirë në këto projektligje, amendamente dhe politika në një masë mesatare. Siç u përmend, kontributi i OGSH-ve është përfshirë në dokumentet e anëtarësimit në BE dhe strategjitë përkatëse, të tilla si NPISAA, ERA dhe Programi i Reformës Ekonomike (PRE). Megjithatë, më pak rekomandime nga OSHCG-të, janë përfshirë në ligje, rregullore dhe udhëzime administrative. Qeveria nuk ka identifikuar ende një mënyrë për të përfshirë në konsultimet publike më shumë organizata të ndryshme të shoqërisë civile, veçanërisht ato nga niveli lokal. Kontributi i tyre mund të informoj hartimin e ligjeve dhe politikave në mënyrë që ato t'u përgjigjen më mirë nevojave të grave dhe burrave të ndryshëm. Më tej, ministritë e linjës konsultohen minimalisht me zyrtarët e barazisë gjinore (ZBGJ) në ministri gjatë hartimit të politikave publike. LBGJ parashikon përfshirjen e ZBGJ-ve në grupet e punës për politikëbërje, megjithatë ato rrallë janë të përfshira në mënyrë adekuate. ZBGJ-të priren të jenë në kontakt më të ngushtë me OSHCG-të, kështu që ata mund të mbështesin angazhimin e përmirësuar dhe përfshirjen e rekomandimeve të OSHCG-ve në politikëbërje. Megjithatë, shumica e ZBGJ-ve gjithashtu duhet të avancojnë kapacitetet e tyre në politikëbërje për të qenë në gjendje të kontribuojnë në mënyrë domethënëse në politikat e reja nga perspektiva gjinore.⁵⁸

Për të vlerësuar shkallën në të cilën strategjitë e reja sektoriale përfshijnë barazinë gjinore, RrGK përdori Planin e Dokumenteve Strategjike të Kosovës 2021-2023, duke analizuar strategjitë sektoriale të hapura për konsultim publik. Ky plan është përgatitur në bazë të propozimeve të ministrive për hartimin e dokumenteve strategjike për këtë periudhë. Nga 36 strategjitë e listuara në këtë Plan, analiza e RrGK-së zbuloi se 17 strategji mbetën si draft deri në fund të vitit 2022 (47%), ndërsa 19 ishin të publikuara dhe të hapura për konsultime publike (53%). Strategjitë zakonisht hapen për konsultime në platformën zyrtare të konsultimit publik.⁵⁹ Nga 19 strategji të publikuara, 15 nuk i kushtojnë fare vëmendje gjinisë; të dhënat brenda tyre nuk janë të ndara sipas gjinisë në pjesët e nevojshme. Katër strategji kanë përfshirë perspektivën gjinore në mënyrë të moderuar: Strategjia për Migracionin 2021-2025; Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore në Kosovë 2022-2026; Strategjia e Sundimit të Ligjit 2021-2026; dhe Programi Kombëtar për të Drejtat e Njeriut.

Si përmbledhje, shumica e strategjive që kanë të bëjnë me barazinë gjinore janë të hapura për konsultime publike dhe mbeten si drafte, ndërsa ato që janë publikuar nuk i kushtojnë vëmendje të mjaftueshme barazisë gjinore. Në shumicën e rasteve, ato përmendin sfidat dhe identifikojnë barrierat që lidhen me përfshirjen e perspektivës gjinore në fushat e politikave. Megjithatë, planet korresponduese të veprimit të këtyre strategjive nuk përfshijnë asnjë objektive, masë, tregues, pikënisje ose objektiva që lidhen me barazinë gjinore.

Meqenëse Kosova është në një fazë të hershme të procesit të anëtarësimit në BE, Qeveria ende nuk ka krijuar grupe punuese sektoriale për kapitujt e ndryshëm të Acquis.⁶⁰ RrGK ka avokuar që është e rëndësishme të sigurohet që OSHCG-të të përfshihen në këto grupe punuese.

G. QEVERIA ZBATON REKOMANDIMET PËR BARAZINË GJINORE TË PËRFSHIRA NË RAPORTIN E VENDIT

Ky kriter shqyrton shkallën në të cilën qeveria dhe institucionet përgjegjëse kanë zbatuar rekomandimet për barazinë gjinore, të cilat ishin në Raportin e KE-së për Kosovën për vitin 2020 dhe 2021. Rekomandimet i referohen rekomandimeve zyrtare në kutitë gri dhe rekomandimeve të përfshira në tregimin e kapitujve. Kjo analizë e shpejtë bazohet në vlerësimin e zbatimit të

⁵⁷ Intervistë e RrGK me ABGJ-në në Mars 2022.

⁵⁸ Vëzhgimet e RrGK gjatë kryerjes së intervistave me ZBGJ-në në lidhje me raportin e saj të ardhshëm mbi "Gjinia dhe digitalizimi".

⁵⁹ Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, Zyra për Qeverisje të Mirë, [Platforma e Konsultimeve Publike](#).

⁶⁰ Korrespondenca e RrGK me Koordinatorin Kombëtar të IPA-së, Prill 2022.

RrGK-së sipas dokumenteve të disponueshme publikisht dhe kërkesave për të dhëna të paraqitura përmes hulumtimit të saj.

Tabela G. Niveli i zbatimit të rekomandimeve për barazinë gjinore të përfshira në Raportin e vendit, nga Qeveria e Kosovës	2021	2022	Ndryshimi
36. Niveli i zbatimit të rekomandimeve për barazi gjinore të përfshira në Raportin e Kosovës nga qeveria ose institucionet	Minimalisht	Minimalisht	0

Raporti i Kosovës 2021 dhe 2022 rekomanduan brenda “kutisë gri⁶¹”, “për të forcuar zbatimin e LBGJ dhe për të siguruar funksionimin e duhur të sistemit të mbrojtjes, parandalimit dhe gjykimit të të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore”. Kërkesat për monitorimin dhe të dhënat e RrGK-së dërguar institucioneve sugjerojnë se disa aspekte të LBGJ-së kanë janë zbatuar dobët, siç është sigurimi i disponueshmërisë së të dhënave të ndara sipas gjinisë, barazia gjinore në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës publike, dhe buxheti i përgjegjshëm gjinor.

ZBGJ-të vazhdojnë të kenë mungesë të kapaciteteve adekuate për kryerjen e përgjegjësi të tyre dhe janë ende të anashkaluara nga proceset vendimmarrëse, gjë që minon shkallën në të cilën barazia gjinore mund të përfshihet në proceset e politikave dhe vendimmarrjes në të gjitha nivelet sipas LZGJ.⁶² Pavarësisht përmirësimeve, si Ministria e Drejtësisë dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore në bashkëpunim me RrGK dhe akterë të tjerë për hartimin e Protokollit Shtetëror për Trajtimin e rasteve të Dhunës Seksuale, vëmendja ndaj dhunës me bazë gjinore mbetet e pamjaftueshme. Financime të mëtijshme duhet të ndahen për të gjitha politikat dhe strategjitë në fuqi; dhe masat rehabilituese për viktimat dhe autorët e dhunës ende mungojnë. Disa ligje që kanë të bëjnë me mirëqenien e grave dhe vajzave, duke përfshirë mirëqenien e tyre fizike dhe ekonomike, mbetën në draft në vitin 2022, si Projektligji për Strehimin Social, Projektligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Projektligji për Punën dhe Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore.⁶³ Për më tepër, trajnimi i duhur i të gjithë sistemit të drejtësisë për dhunën me bazë gjinore ende nuk është institucionalizuar plotësisht, duke përfshirë edhe Fakultetin Juridik. Kështu, pavarësisht progresit, RrGK vlerëson se zbatimi i LBGJ-së dhe funksionimi i duhur i “sistemit të mbrojtjes, parandalimit dhe gjykimit të të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore” kanë mbetur të dobëta.

Së dyti, Raporti i Kosovës 2021 dhe 2022 rekomanduan në një kuti gri “të miratohet dhe zbatohet Ligji i Punës në përputhje me acquis përkatëse të BE-së, veçanërisht në lidhje me mosdiskriminimin në punësim dhe pushimin prindëror”. Ndryshimet e nevojshme në Ligjin e Punës sipas acquis përkatëse të BE-së, veçanërisht Direktiva e BE-së për Balancimin e Punës dhe Jetës, nuk janë përfunduar dhe ligji nuk është miratuar. Prandaj, ai nuk mund të zbatohet. Hulumtimi i RrGK-së sugjeron që Ligji aktual i Punës vazhdon të kontribuoj në diskriminimin me bazë gjinore në punë.⁶⁴ Legjislacioni dytësor vazhdoi të hartohej, në përputhje me Ligjin aktual të Punës, pa perspektivë gjinore.

Së treti, lidhur me rekomandimin për Drejtësi, Liri dhe Siguri: “Zbatoni strategjinë dhe planin e veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2022-2026, duke adoptuar një qasje të përqendruar te viktimat”, RrGK vazhdon të dëshmoj fajësimin e viktimave në mesin e policëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në përgjithësi, hulumtimi sugjeron që Qendrave për Punë Sociale ende u mungojnë kapacitetet për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore duke përdorur një qasje të ndjeshme gjinore.⁶⁵

Së katërti, në lidhje me rekomandimin e kutisë gri për Zhvillimin Ekonomik dhe Konkurrueshmërinë: “Zbatoni masa aktive të tregut të punës për të mbështetur punësimin, rifilloni

⁶¹ Gray boxes, në kuadër të së cilave renditen rekomandimet kyce për qeverinë e Kosovës

⁶² Vëzhgimet e RrGK gjatë kryerjes së intervistave me ZBGJ-në në lidhje me raportin e saj të ardhshëm mbi “Gjinia dhe digitalizimi”.

⁶³ Kjo u miratua në tetor 2023.

⁶⁴ RrGK, [Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Kosovë](#), botimi i dytë, Prishtinë: 2022.

⁶⁵ Adelina Berisha dhe Nicole Farnsworth për RrGK, [Vlerësimi i Ofrimit të Shërbimeve nga Qendrat për Punë Sociale për të Mbijetuarit e Dhunës në Familje](#), RrGK: 2022.

publikimin e të dhënave të anketës së fuqisë punëtore dhe vazhdoni të zbatoni masa që synojnë formalizimin e punësimit informal”. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) nuk e ka përditësuar Anketën e Fuqisë Punëtore që nga viti 2021. Që nga viti 2022, Qeveria nuk kishte ndonjë strategji për të adresuar informalitetin, veçanërisht nga perspektiva gjinore. RrGK po kryen një analizë gjinore për të informuar strategjinë e re të qeverisë, për të adresuar informalitetin.

Kështu, në përgjithësi, përkundër angazhimeve dhe disa përmirësimeve, qeveria e Kosovës ka përmbyshur minimalisht rekomandimet e Raportit të Kosovës 2022 në lidhje me barazinë gjinore.

H. PROGRAMIMI I IPA III NË NIVEL KOMBËTAR PRIORITET E BARAZISË GJINORE

Ky kriter shqyrton shkallën në të cilën Programimi i Instrumentit për Para-Anëtarësim (IPA) III i jep përparësi barazisë gjinore.

Tabela H. Masa në të cilën Programimi i IPA III i jep përparësi barazisë gjinore	2021	2022	Ndryshimi
37. Niveli i konsultimit të organeve përgjegjëse qeveritare me organizatat e grave për zhvillimin e Programeve Indikative Shumëvjeçare të Përgjigjes Strategjike IPA III	Aspak	Aspak	0
38. Niveli i përfshirjes së objektivave gjinore në Programin Indikativ Shumëvjeçar [Përgjigja Strategjike IPA III]	Dokumenti nuk është publik	Dokumenti nuk është publik	0
39. Niveli i perspektivës gjinore prezent në Programet Indikative vjetore ose Dokumentet e Veprimit	I Moderuar	I Moderuar	0

Historikisht, Programi Indikativ Shumëvjeçar synar të sigurojë konsistencë midis fushave kyçe të ndërhyrjes së BE-së dhe prioriteteve të shprehura nga vendet përfituese. Me IPA III, në BP, duke pasur parasysh kontekstin e vecantë të procesit të anëtarësimit, në vend të përgatitjes së këtyre dokumenteve, qeverive u është kërkuar të përgatisin një Përgjigje Strategjike ndaj IPA III. Sipas të gjeturave, qeveria nuk është konsultuar fare me OSHCG-të në hartimin e këtij dokumenti. RrGK pati mundësinë që ta shqyrtoj Përgjigjen Strategjike ndaj IPA III shkurtimisht vetëm sepse ZBEK/PSBE ndau draft dokumentin për shqyrtim në komunikim të brendshëm. Përgjigja Strategjike IPA III nuk është vënë në dispozicion të publikut, dhe për këtë arsye niveli në të cilin ajo përfshin objektivat e barazisë gjinore nuk mund të analizohet.

Më 15 dhjetor 2021, KE publikoi [Vendimin Zbatues përfundimtar të Komisionit për financimin e planit vjetor të veprimit në favor të Kosovës për vitin 2022](#). Në paragrafin 5 të këtij vendimi specifikohet se objektivat e ndjekura nga plani vjetor i veprimit në favor të Kosovës për vitin 2021 anojnë nga mbrojtja e të drejtave të njeriut, barazia gjinore dhe siguria publike, ndër objektiva të tjera. Neni 1 përcakton katër veprime: 1) BE-ja për të drejtat themelore; 2) Përafrimi me BE-në; 3) BE për Mjedisin dhe Energjinë e Gjelbër; dhe 4) BE për zhvillim socio-ekonomik gjithëpërfshirës.

RrGK përdori kriteret minimale të KAZH të [OBZHE KAZH](#) për vlerësimin gjinor për të analizuar çdo dokument veprimi nga perspektiva gjinore, duke përdorur treguesit e mëposhtëm:

- A është caktuar një shënjeshtër gjinor?
- A ishte mjaftueshëm e përfshirë analiza gjinore në analizën e problemit ose situatës që informoi veprimin?
- A ishte përfshirë të paktën një objektiv drejt barazisë gjinore në një objektivë specifike (GM1) ose objektivë të përgjithshme (GM2), drejt adresimit të pabarazive gjinore dhe nevojave të identifikuara përmes analizës gjinore?
- A masin treguesit zbatimin e objektivave drejt barazisë gjinore?
- A janë të ndarë të gjithë treguesit, linjat bazë dhe objektivat sipas gjinisë?

Për më tepër, bazuar në PVGJ II dhe të aluduar në PVGJ III, RrGK vlerësoi: deri në çfarë mase ishin të angazhuara OSHCG-të në procesin e hartimit të dokumenteve të veprimit. Tabela 1 përmbledh gjetjet, duke përdorur sistemin "Boolean" ku "0" do të thotë jo, "0.5" do të thotë pjesërisht dhe "1" do të thotë plotësisht. Duke përdorur këtë metodologji pikëzimi, përqindja e të gjashtë dokumenteve të veprimit që plotësojnë kriteret llogaritet në rreshtin e fundit, duke mundësuar krahasime me kalimin e kohës. Çdo dokument veprimi vlerësohet shkurtimisht.

Tabela 1. Niveli që dokumentet e veprimit plotësuan kriteret e OBZHE KAZH për përfshirjen gjinore

Kriteret e OBZHE KAZH	(a) Të Drejtat Themelore	(b) Përafrimi me BE-në	(c) BE për Mjedisin dhe Energjinë e Gjelbër	(d) BE për zhvillim socio-ekonomik gjithëpërfshirës
Shënjesi gjinor është caktuar?	1	1	1	1
Analiza gjinore përfshihet mjaftueshëm në analizën e problemit/situatës?	1	0.5	1	1
Të paktën një objektivë drejt barazisë gjinore?	1	0	0	1
Treguesit matin zbatimin e objektivave drejt barazisë gjinore?	0.5	0	0.5	0.5
Të gjithë treguesit, linjat bazë dhe objektivat të ndara sipas gjinisë?	1	0	0.5	0.5
OSHCG-të të konsultuara në hartim?	1	1	1	1
Përqindja e kriterëve të përmbushura për dokument veprimi	92%	42%	67%	83%

Dokumenti i Veprimit për të Drejtat Themelore të BE-së përfshin barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave si një objektiv të rëndësishme. Kjo e bën dokumentin GM1. DV përfshin dy rezultate që kanë të bëjnë me barazinë gjinore (Rezultati 1: “Për të mbështetur akterët publik dhe joqeveritar në Kosovë në zbatimin e një kthimi të qëndrueshëm, të ndjeshëm gjinor dhe riintegrimin e deri në 260 familjeve të zhvendosura në Kosovë”; dhe Rezultati 2: Të lehtësohen gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët për të marrë njohuri mbi standardet evropiane të të drejtave të njeriut dhe acquis të BE-së, duke përfshirë acquis për barazinë gjinore.)⁶⁶ Këto rezultate kanë tregues përkatës të ndarë sipas gjinisë. Megjithatë, këto duken të paqarta. Për Rezultatin 1, treguesi është: “Numri i projekteve zhvillimore të bazuara në komunitet që përfshijnë burra dhe gra nga komunitetet e kthiera dhe pranuese”. Objektivi është 60 projekte, por kjo nuk do të masë përfshirjen e grave dhe burrave. Më tej një projekt është një aktivitet, ndërsa matja e riintegritimit të suksesshëm të njerëzve do të ishte rezultati. Në mënyrë të ngjashme, Rezultati 2 ka parashikuar treguesit: “Numrin e a) gjyqtarëve, b) prokurorëve, c) avokatëve dhe d) stafit të gjykatave të trajnuar me mbështetjen e BE-së për standardet evropiane dhe Acquis të BE-së, të ndara sipas gjinisë” dhe “Numri i studentëve dhe profesorëve të drejtësisë të trajnuar dhe çertifikuar pas trajnimit mbi standardet e Këshillit të Evropës, të ndarë sipas gjinisë”. Megjithatë, objektivi nuk është i ndarë sipas gjinisë dhe është e paqartë se sa nga kurrikula e trajnimit do t'i kushtohet Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore, siç thuhet në rezultat.

Dokumenti i Veprimit për Përafrimin me BE-në përfshin barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave si një objektiv të rëndësishëm, pra GM1. Dokumenti përfshin një analizë shumë të shkurtër gjinore, duke vënë në pah se “Përfshirja gjinore është veçanërisht e rëndësishme për përafrimin me acquis të BE-së, pasi barazia gjinore e BE-së është një element thelbësor i acquis-së dhe kështu fusha e mbështetjes 1 gjithashtu kontribuon në barazinë gjinore.”⁶⁷ Analiza e shkurtër gjinore vë në dukje se Zyra e KKIPA, Agjencia për Barazi Gjinore dhe ministritë e linjës do të vazhdojnë të zhvillojnë ndërtimin e kapaciteteve drejt integritimit gjinor në të gjithë programet e IPA-s dhe se “veprimi është plotësisht në përputhje me Strategjinë e BE-së për Barazinë Gjinore 2020-2024, duke mbështetur integrimin gjinor dhe përfshirjen sistematike të BE-së.” Megjithatë, nuk ka asnjë referencë për Vlerësimet e Ndikimit Gjinor (VNGJ), sipas LBGJ-së së Kosovës e cila kërkon saktësisht që VNGJ të kryhen për të informuar politikëbërjen. Më tej, nuk ka rezultate, tregues, vija bazë ose objektiva që lidhen me integrimin gjinor, veçanërisht me ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve në integrimin gjinor. Vetëm një tregues kërkon të dhëna të ndara sipas gjinisë; Matrica Indikative e Kornizës Logjike nuk përmban asnjë rezultat tjetër, tregues, bazë ose objektiva që lidhen me barazinë gjinore. Si i tillë, Dokumenti i Veprimit

⁶⁶ KE, Drejtoria e Përgjithshme për Politikat Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit (DP PEFNZ), SHTOJCA 1 e Vendimit Zbatues të Komisionit për financimin e planit vjetor të veprimit në favor të Kosovës për vitin 2022, [Dokumenti i Veprimit për BE-në për të Drejtat Themelore](#).

⁶⁷ KE, DP PEFNZ, SHTOJCA 2 e Vendimit Zbatues të Komisionit për financimin e planit vjetor të veprimit në favor të Kosovës për vitin 2022, [Dokumenti i Veprimit për Përafrimin me BE-në](#).

për Përafrimin me BE-në nuk i përmbush të gjitha kriteret e OBZHE KAZH për t'u shënuar GM1. Kështu, DV nuk është e saktë.

Dokumenti i Veprimit për BE-në për Mjedisin dhe Energjinë e Gjelbër përfshin barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave si një objektiv të rëndësishëm, pra GM1. Nga nëntë tregues gjithsej, vetëm pesë janë të ndara sipas gjinisë. Megjithatë, nuk ka baza përkatëse të ndara sipas gjinisë ose objektiva për të matur zbatimin dhe rezultatet. Dokumenti ka një analizë gjinore që diskuton punësimin e grave në sektorin e mjedisit, si dhe nevojën për masa më afirmative në këtë aspekt.⁶⁸ Megjithatë, kjo analizë nuk pasqyron rezultatet, rezultatet ose treguesit përkatës në Matricën e Kornizës Logjike Treguese. Nevoja për masa afirmative është përfshirë në Kornizën e Vlerësimit të Riskut, si masë lehtësuese,⁶⁹ por jo në Matricë. Seksioni i analizës gjinore përmend se “Masat e ngritjes së kapaciteteve [në lidhje me menaxhimin e mbetjeve] do të identifikohen dhe hartohen bazuar në një analizë të boshllëqeve institucionale dhe vlerësime të nevojave për trajnim”; dhe se “Këto do të bazohen në qasje të ndjeshme gjinore dhe gjithëpërfshirëse për të promovuar mundësi të barabarta.” Megjithatë, një VNGJ nuk është parashikuar as në Matricë, megjithëse Vlerësimet e Ndikimit Mjedisor dhe Vlerësimet e Ndikimit Social janë parashikuar dhe përmendur në mënyrë specifike. Matrica nuk përfshin rezultate, rezultate ose aktivitete që synojnë barazinë gjinore. Ai përfshin vetëm tre tregues që përmendin gratë, por duke mos i synuar ato drejtpërdrejt, pasi në Dokument thuhet se ai synon “të rris barazinë gjinore”.⁷⁰ Treguesit janë kryesisht për sa i përket të dhënave të ndara sipas gjinisë të pjesëmarrësve dhe/ose përfutuesve. Ndërsa shumica e kriterëve për një GM1 janë përmbushur, objektivat mund të ishin të ndara sipas gjinisë.

Dokumenti i Veprimit për BE-në për zhvillim socio-ekonomik gjithëpërfshirës përfshin barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave si një objektiv të rëndësishëm, pra GM1. Veprimi thekson se ai “është hartuar dhe do të zbatohet sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të barazisë gjinore duke përfshirë Ligjin e Kosovës për Barazi Gjinore, Programin e Kosovës për Barazi Gjinore dhe Planin III të Veprimit Gjinor të BE-së”. Ai ka një analizë të shkurtër gjinore në tre fushat e mbështetjes: 1. “Stabilizimi i Komunitetit”; 2. “Përfshirja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim”; dhe 3. “Mbështetje për vullnetarizmin e të rinjve”.⁷¹ Analiza diskuton çështjet me të cilat përballen gratë dhe vajzat nga këto komunitete. Tre nga rezultatet kanë qëllim të synojnë në mënyrë të barabartë gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë.⁷² Të tre rezultatet kanë tregues përkatës që lidhen me barazinë gjinore. Megjithatë, ato nuk kontribuojnë domosdoshmërisht në synimet e rezultateve për barazinë gjinore. Për shembull, drejt rezultatit 1: “Krijimi i mundësive për gjenerimin e të ardhurave dhe përmirësimi i përfshirjes sociale për gratë dhe burrat nga komunitetet joshumicë në Kosovë”; përmes daljes 1: “Asociacionet e biznesit jo-shumicë dhe ndëretnike/kooperativat/iniciativat e komunitetit dhe/ose ndërmarrjet sociale mbështeten për të adresuar nevojat e komunitetit dhe për të krijuar mundësi punësimi”, propozohen treguesit e mëposhtëm: “# i shoqatave të biznesit (SHB) të krijuara në zonat e synuara për të krijuar prodhim të ri me vlerë të shtuar më të lartë në asistencë në zinxhirin e vlerës”; “# i bizneseve fillestare dhe operative në zonat e synuara të krijuara nëpërmjet disbursimit të asistencës në fund të nismës”; “# i vendeve të punës e që janë të qëndrueshme,

⁶⁸ KE, DP PEFNZ, SHTOJCA 3 e Vendimit Zbatues të Komisionit për financimin e planit vjetor të veprimit në favor të Kosovës për vitin 2022, [Dokumenti i Veprimit për BE-në për Mjedisin dhe Energjinë e Gjelbër](#).

⁶⁹ Po aty., f. 10. “Dialogu i vazhdueshëm dhe ndërtimi i kapaciteteve për rekrutimin me ndjeshmëri gjinore dhe mundësi të barabarta në përputhje me legjislacionin përkatës drejt rritjes së përfaqësimit të grave.”

⁷⁰ Po aty., f. 5.

⁷¹ KE, DP PEFNZ, SHTOJCA 4 e Vendimit Zbatues të Komisionit për financimin e planit vjetor të veprimit në favor të Kosovës për vitin 2022, [Dokumenti i Veprimit për BE-në për zhvillim socio-ekonomik gjithëpërfshirës](#).

⁷² Po aty. “Rezultati 1: krijimi i mundësive për gjenerimin e të ardhurave dhe përmirësimi i përfshirjes sociale për gratë dhe burrat nga komunitetet joshumicë në Kosovë; Rezultati 2: Sigurimi i qasjes së barabartë të vajzave dhe djemve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm duke përmirësuar regjistrimin, mbajtjen dhe arritjen e fëmijëve përmes mbështetjes financiare dhe të bazuar në komunitet; Rezultati 3: shërbime të përshtatshme mbështetëse dhe financim për zhvillimin e programeve të vullnetarizmit për të rinjtë dhe të rejtat.”

afatgjata, e të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike". Asnjë nga këto nuk përfshin masa afirmative për të kontribuar në mundësitë e barabarta të gjenerimit të të ardhurave për gratë dhe burrat. Sigurimi i të dhënave të ndara vetëm sipas gjinisë, për numrin e vendeve të punës të krijuara e që janë afatgjata e të qëndrueshme nuk është domosdoshmërisht i mjaftueshëm për përmirësimin e situatës; Ka të ngjarë të nevojiten masa dhe objektiva afirmative për mbështetjen e rekrutimit të barabartë dhe mundësive të punësimit. Në mënyrë të ngjashme, drejt rezulttit 2,⁷³ përmes Produktit 2: "Përfshirja e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian nga komunitetet e synuara në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm të ulët dhe përmirësimi i rezultateve të tyre të të nxënësve", treguesi është: "% e vijueshmërisë së shkollës (në secilin komunitet) në arsimin parafillor dhe atë të detyrueshëm, të ndara sipas gjinisë." Nuk janë përfshirë masa apo aktivitete specifike që do të kontribuonin në një qasje të përgjegjshme gjinore, të përshtatur, në rritjen e regjistrimit të vajzave dhe djemve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në mënyrë të barabartë. Modeli është i ngjashëm edhe me Rezultatit 3. Nuk parashikohen masa afirmative për treguesit përkatës (p.sh., numri i vullnetarëve të mbështetur dhe shërbimet e informacionit dhe ndërgjegjësimit).⁷⁴ Më tej, megjithëse treguesit janë të ndarë sipas gjinisë, asnjë nga linjat bazë dhe objektivat nuk janë. Kjo e bën të vështirë matjen e rezultateve dhe kontributeve për barazinë gjinore. Si i tillë, megjithëse Dokumenti është shënuar GM1 dhe përmbush disa kritere (p.sh., analiza gjinore, disa të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe disa rezultate të ndara sipas gjinisë), nuk është e qartë se si Veprimi do të kontribuojë drejtpërdrejt në gjininë, barazinë dhe gratë, fuqizimin e vajzave. Pra, shënimi i këtij veprimi është i pasaktë.

Në përgjithësi, të katër Dokumentet e Veprimit për vitin 2022 janë shënuar si GM1. Të gjithë kanë të përfshirë analizën gjinore. Megjithatë, pabarazitë dhe çështjet e identifikuara në analizën gjinore jo gjithmonë informojnë mjaftueshëm rezultatet. Në lidhje me Matricat e Kornizës Logjike, Dokumentet ndonjëherë përfshinin tregues të ndarë sipas gjinisë, por këta nuk shoqëroheshin me bazën përkatëse, objektivat dhe aktivitetet që kontribuojnë në barazinë gjinore, drejtpërdrejt ose tërthorazi. Treguesit janë të integruar kryesisht në aspektin gjinor për sa i përket numrit të përfituesve të projekteve ose pjesëmarrësve, gjë që nuk do të thotë domosdoshmërisht se barazia gjinore do të jetë një objektiv ose rezultat i rëndësishëm i zbatimit të këtyre Dokumenteve të Veprimit pa vendosur objektiva të qarta ndryshimi.

Mekanizmat e barazisë gjinore si ABGJ dhe ZBGJ nuk janë konsultuar në hartimin e Dokumenteve të Veprimit. Në të kundërt, OSHCG-të u konsultuan sepse EUOK kontrakttoi RrGK për të rishikuar çdo Dokument Veprimi dhe për të mbështetur BE-në në sigurimin e zbatimit të kritereve të KAZH të OBZHE. Pavarësisht nga mangësitë e lartpërmendura, kjo praktikë e mirë ka kontribuar qartë në përmirësimin e vëmendjes ndaj barazisë gjinore në Dokumentet e Veprimit, duke institucionalizuar njëkohësisht konsultimin me OBSH-të në procesin e planifikimit të programimit të IPA-s.⁷⁵ Megjithatë, Qeveria ende duhet të institucionalizoj konsultime të tilla me shoqërinë civile si pjesë e programimit të IPA-s, dhe kontrata e RrGK me BE-në ka përfunduar në vitin 2022, kështu që se si do të mbahen konsultimet me OSHCG-të gjatë programimit në të ardhmen pritet të shihet.

⁷³ Po aty. "Të sigurohet qasje e barabartë e vajzave dhe djemve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm duke përmirësuar regjistrimin, mbajtjen dhe arritjen e fëmijëve përmes mbështetjes financiare dhe të bazuar në komunitet."

⁷⁴ Rezultati 3. "Mbështetje për Vullnetarizmin", "Shërbime adekuate mbështetëse dhe financim për zhvillimin e programeve të vullnetarizmit për të rinjtë dhe të rejtat"; Rezultati 3: "Rritja e mbështetjes shtetërore, financimi dhe vizibiliteti i programeve të vullnetarizmit"; Treguesit: "# i programeve të financuara si pjesë e programeve vullnetare" dhe "# i mbështetjes së vullnetarëve dhe shërbimit të informimit dhe ndërgjegjësimit".

⁷⁵ Kjo është vërejtur nga zyrtarë të KE-së, si dhe nga OSHCG-të.

I. TË DHËNAT GJINORE TË ZBATUARA JANË MBLEDHUR NGA ZYRAT KOMBËTARE STATISTIKORE

Ky kriter shqyrton masën në të cilën të dhënat e ndara sipas gjinisë mbledhen nga zyrat kombëtare të statistikave. Të dhëna të tilla janë thelbësore për politikëbërjen e bazuar në prova.

Tabela I. Masa në të cilën mbledhen të dhënat e ndara sipas gjinisë nga Zyrat Kombëtare të Statistikave	2021	2022	Ndryshimi
40. Vendi ka një Indeks të Barazisë Gjinore (IBGJ) të përditësuar në nivel kombëtar	Jo	Jo	0
41. Nëse Zyrat Kombëtare të Statistikave publikojnë një raport me të dhëna të qasshme lehtësisht e të ndara sipas gjinisë, që është e mjaftueshme për përdorim nga publiku	Mesatare	Mesatare	0

ABGJ dhe ASK kanë vazhduar të punojnë në themelimin e tri fushave të IBGJ-së për Kosovën: Dituria, Fuqia dhe Paraja. Megjithatë, këto ende nuk janë publikuar. Fakti që Kosova nuk është pjesë e shumë nismave hulumtuese të EUROSTAT-it, duke përfshirë Anketën Evropiane për Kushtet e Punës, e kombinuar me mungesën e vullnetit politik, ka ngadalësuar mbledhjen e të dhënave të nevojshme për themelimin e IBGJ.⁷⁶

ASK, në bashkëpunim me ABGJ, publikon periodikisht *Gratë dhe Burrat në Kosovë*, dhe publikimi i fundit i tillë ka qenë në vitin 2020 me të dhëna nga viti 2019-2020.⁷⁷ Të dhënat e ndara sipas gjinisë nuk janë plotësisht të mjaftueshme për përdorim nga publiku, pasi disa të dhëna nuk janë të disponueshme. Për shembull, disa tregues kryesor nuk janë të ndarë sipas gjinisë dhe vendndodhjes urbane/rurale dhe/ose përkatësisë etnike.

J. ORGANET KOMBËTARE PËRGJEGJËSE PËR INTEGRIMIN NË BE PËRFSHIJNË STAF ME EKSPEERTIZË GJINORE

Ky kriter shqyrton shkallën në të cilën organet kombëtare përgjegjëse për integrimin në BE përfshijnë staf me ekspertizë gjinore.

Pas reformave të qeverisë në vitin 2021, Ministria e Integrimit Evropian u shfuqizua. Zyra e Koordinatorit Kombëtar të IPA-së (KKIPA), e quajtur më parë Departamenti për Asistencë Zhvillimore, ishte integruar në ZKM. Ajo u riemërua Zyra për Bashkëpunim dhe Zhvillim, por mbajti të njëjtat përgjegjësi dhe pozita si në rolin e saj të mëparshëm. Ndërkohë, në vitin 2021, një pjesë e stafit u largua nga Zyra për Bashkëpunim dhe Zhvillim dhe filluan të punojnë në sektorin privat apo organizata ndërkombëtare ku pozitat e tyre kanë mbetur të paplotësuara duke përfshirë edhe vitin 2022.

Tabela J. Masa në të cilën organet kombëtare përgjegjëse për integrimin në BE përfshijnë staf me ekspertizë gjinore	2021	2022	Ndryshimi
42. Niveli i ekspertizës gjinore në organin qeveritar për integrimin në BE	Mesatar	Mesatar	0
43. % e stafit të trajnuar në vitin 2022 për barazinë gjinore në organin kombëtar përgjegjës për integrimin në BE	0%	0%	0
44. Niveli i konsultimit të Pikat Qëndrore Gjinore në programimin IPA	Minimal	Minimal	0
45. Niveli i ekspertizës për barazinë gjinore në zyret kombëtare të statistikave	Minimal	Minimal	0

Kordinatori nacional i IPA (NIPAC) kishte në të kaluarën një person me përgjegjësi për të vepruar si një pikë qendrore për referenca gjinore. Megjithatë, aktualisht ky post është i zbrazët

⁷⁶ Intervistë e RrGK, 2022.

⁷⁷ ASK dhe ABGJ, [Gratë dhe Burrat në Kosovë](#), 2020.

dhe nuk është e qartë nëse dikush ka marrë përsipër integrimin e perspektivës gjinore brenda NIPAC specifikisht. Pjesa tjetër e stafit përbërës të NIPAC ka ndjekuar trajnime mbi barazinë gjinore nga RrGK në vitet e mëparshme, si pjesë e asistencës së ofruar me mbështetjen e ZBEK-ut. Megjithatë, stafi aktual i NIPAC duket se nuk ka marrë trajnime të mëtejme për barazinë gjinore në vitin 2022. Një trajnim i tillë është i nevojshëm në mënyrë që stafi të siguroj vëmendje ndaj cilësisë gjinore si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE.

Korrespondenca e RrGK me pikat qendrore gjinore, ABGJ dhe NIPAC sugjeron që MKBGJ nuk janë konsultuar gjatë procesit të programimit të IPA-s. ABGJ është konsultuar në lidhje me veprime specifike të barazisë gjinore. Megjithatë, ABGJ dhe zyrtaret e barazisë gjinore në ministrinë përkatëse nuk janë konsultuar në hartimin e veprimeve të tjera. Raportohet se Zyra e NIPAC vazhdon të përballet me lëvizje të stafit, të ngjashme me ato të përgjithshmet të administratës publike, si dhe me ekspertizë minimale të barazisë gjinore për të informuar dokumentet IPA III nga perspektiva gjinore.

Ndërkohë, ASK-ja ka një person që shërben si pikë qendrore gjinore, por është e paqartë nëse kjo përgjegjësi është zyrtarisht pjesë e përkrahjes së punës së saj. Për më tepër, fakti që kjo pozitë bie në kuadër të një seksioni mund të pengoj shkallën në të cilën ajo mund të mbështes mbledhjen dhe raportimin e statistikave gjinore nëpër sektorë të ndryshëm.

KONKLuzion

Në përgjithësi, integrimi gjinor i procesit të anëtarësimit në BE është përmirësuar me përafërsisht 19% nga viti 2021 deri në vitin 2022. Edhe pse Komisioni Evropian e përmirësoi integrimin gjinor të Raportit të Kosovës në vitin 2022, ekzistojnë mundësi për integrim të mëtejshëm gjinor, duke e përfshirë në kapituj të ndryshëm, duke paraqitur të dhëna kyçe të ndara sipas gjinisë dhe duke përfshirë më shumë rekomandime në lidhje me barazinë gjinore. Ndërkohë që konsultimet e BE-së dhe qeverisë me OSHC-të, përfshirë OSHCG-të, janë përmirësuar, nevojitet një strategji e mëtejshme për të përfshirë më shumë OSHC të ndryshme, si dhe për të siguruar që vëmendja ndaj barazisë gjinore të integrohet në të gjitha agjendat dhe konkluzionet e strukturave të MSA-së. Kontraktimi i RrGK nga ZBEK, si një OSHCG me ekspertizë në integrimin gjinor, kontribuoi qartë në konsultimet e BE-së me shoqërinë civile, veçanërisht në lidhje me CLIP-in dhe programimin. Megjithatë, angazhimi i BE-së me shoqërinë civile, veçanërisht OSHCG-të, në lidhje me dialogun politik, gratë, paqen dhe sigurinë, dhe si pjesë e dialogut Prishtinë-Beograd, përkatësisht, ka qenë i pamjaftueshëm. BE-ja është angazhuar në mënyrë të moderuar me homologët e qeverisë për çështjet e barazisë gjinore, por në mënyrë të pamjaftueshme me parlamentin, ABGJ-në dhe zyrtarët e barazisë gjinore. BE-ja e ka integruar gjininë në një farë mase në të gjitha dokumentet e veprimit, ndonëse në mënyrë të pamjaftueshme. Megjithatë, metodologjia e OBZHE-së dhe rrjedhimisht e BE-së për Shënuesin Gjinor as nuk mundëson gjurmimin e sasisë së saktë të fondeve të alokuara për barazinë gjinore, as nuk ndjek në mënyrë adekuate fondet e alokuara për OSHCG-të (apo akterë të tjerë), sipas treguesit PVGJ III. Për më tepër, shënimi gjinor nuk ishte gjithmonë i saktë dhe nuk i përmbushte të gjitha kriteret e KAZH të OBZHE. Udhëheqja e BE-së është relativisht e balancuar në aspektin gjinorë dhe shumica e tyre kanë kaluar trajnime për barazinë gjinore, duke përfshirë gratë, paqen dhe sigurinë. Këshilltarët gjinorë dhe pikat fokale ekzistojnë, por nuk janë në pozicione vendimmarrëse ku mund të ndikojnë më mirë në vëmendjen ndaj barazisë gjinore gjatë gjithë punës së BE-së.

Qeveria e Kosovës ka përmirësuar ndjeshëm integrimin gjinor të PKZMSA 2021-2025 krahasuar me vitet e mëparshme falë konsultimeve cilësore vjetore me shoqërinë civile dhe integrimin të kontributit të ofruar nga OSHCG-të gjatë këtyre konsultimeve. Shumica e strategjive të lidhura me barazinë gjinore janë hapur për konsultime publike, megjithëse jo të gjitha i kushtojnë vëmendje të mjaftueshme barazisë gjinore dhe vetëm disa nga rekomandimet e OSHCG-ve janë adresuar. Qeveria ka përparuar minimalisht në zbatimin e rekomandimeve në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën 2021.

Përgjigja Strategjike IPA III as nuk u bë e disponueshme për konsultim publik dhe as nuk u rishikua përmes konsultimeve publike gjatë përgatitjes së saj. Në pjesën më të madhe, dokumentet e veprimit IPA III kanë përfshirë vëmendjen ndaj barazisë gjinore në analizat e

situatës së tyre dhe kanë objektiva dhe tregues drejt barazisë gjinore. Disa përmbajnë tregues të ndarë sipas gjinisë aty ku është e rëndësishme, megjithëse kjo mund të përmirësohet. Mekanizmat e barazisë gjinore si ABGJ dhe ZBGJ nuk janë konsultuar në hartimin e shumicës së dokumenteve të veprimit, ndërsa OSHCG-të janë konsultuar vazhdimisht për shkak se ZBEK ka angazhuar RrGK. Kjo praktikë e mirë kontribuoi në përmirësimin e vëmendjes ndaj barazisë gjinore në dokumentet e veprimit, duke institucionalizuar njëkohësisht konsultimet me OSHCG-të në programimin IPA. Qeveria mund të institucionalizojë konsultime të tilla me shoqërinë civile.

Kosova ende nuk ka një Indeks të Barazisë Gjinore, dhe megjithëse të dhënat për gratë dhe burrat publikohen periodikisht, të dhënat e ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike, ose vendndodhjes rurale/urbane mbeten të padisponueshme.

KKIPA ka ekspertizë minimale për barazinë gjinore. Kosova ka një kornizë institucionale, duke përfshirë ABGJ-në dhe zyrtarët për barazi gjinore, që mund të informojnë programimin e IPA-së nga perspektiva gjinore. Megjithatë, Qeveria nuk ka përfshirë në mënyrë adekuate zyrtarët e ABGJ-së dhe barazisë gjinore në hartimin e programeve të IPA-s. Ekspertiza minimale gjinore ekziston në ASK, dhe ajo është e vendosur kryesisht në një sektor.

REKOMANDIME

PËR BE-NË

- Vazhdimi i avancimit të njohurive dhe pronësisë së të gjithë anëtarëve të stafit të BE-së se si të integrohet perspektiva gjinore në të gjitha pjesët e Raportit të Kosovës, duke përfshirë përdorimin e një qasjeje ndërsektoriale dhe transformuese sipas PVGJ III.
- Vazhdimi i organizimit të konsultimeve kuptimplote me OSHCG të ndryshme dhe kërkimi për të integruar kontributin e tyre në Raportin e Kosovës dhe lidhur me strukturat e MSA-së. Bashkëpunoni dhe hartoni strategji me rrjetet e OSHCG-ve për të rritur konsultimet me gra dhe burra të ndryshëm, duke përfshirë në nivel lokal, me aftësi të kufizuara dhe të etnive të ndryshme. Sigurohuni që OSHCG të ndryshme të marrin ftesa për konsultime dhe që konsultimet të jenë të arritshme për sa i përket gjuhës, aftësisë dhe kohës. Vazhdoni të jepni komente lidhur me rekomandimet e shoqërisë civile që janë përfshirë në raporte dhe konsultime, dhe arsyet pse nuk është përfshirë kontributi i dhënë përmes komenteve.
- Vazhdimi i mbështetjes dhe financimit të analizave gjinore specifike të sektorit të planifikuar dhe buxhetit për një analizë të re, gjithëpërfshirëse dhe të përditësuar gjinore për Kosovën që do të kryhet në vitin 2024.
- Të përmirësohet më tej vëmendja ndaj barazisë gjinore në dialogun politik me Qeverinë e Kosovës, duke përfshirë ABGJ dhe mekanizmat e barazisë gjinore në këto dialogje që lidhen me sektorë të ndryshëm.
- Të sigurohet se ndërmerren dialogje të rregullta, tremujorshe, ndërmjet Shefit të Misionit dhe OSHCG-ve të ndryshme për çështjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave, si dhe në lidhje me kontekstin politik në përgjithësi, sipas angazhimeve të BE-së në Rezolutën 1325 dhe PVGJ III.
- Të ndërmerren veprime të menjëhershme për të siguruar përfshirje të përmirësuar dhe të rregullt të OJQV-ve të ndryshme në Dialogun Prishtinë-Beograd, duke përfshirë konsultimet e rregullta, sipas Rezolutës 1325 të KS të OKB-së.
- Vazhdimi i praktikës së mirë të angazhimit të OSHCG-ve si ekspertë për të mbështetur integrimin gjinor të programimit, ndërkohë që institucionalizohen konsultime të tilla strategjike me ekspert të shoqërisë civile për barazinë gjinore për të informuar programimin.
- Sigurimi i një procesi të sigurimit të cilësisë për të kontrolluar nëse të gjitha dokumentet e Veprimit përmbushin kriteret e OBZHE KAZH për GM1, duke përdorur listat kontrolluese të zhvilluara për ta mbështetur këtë.
- Inkurajoni fuqimisht qeverinë që të angazhojë më mirë OSHCG të ndryshme, ABGJ dhe zyrtarë të barazisë gjinore në procesin e programimit të IPA-s.

- Bashkëpunoni me KE-në për të përmirësuar funksionalitetin e OPSYS për të përcjellë më mirë shpenzimet drejt barazisë gjinore dhe përkatësisht për OSHCG-të dhe lëvizjet. Kjo duhet të përfshij tregues për përcjelljen e shpenzimeve përmes nëngranteve.
- Sigurimi i trajnimit të vazhdueshëm për barazinë gjinore si dhe për gratë, paqen dhe sigurinë për menaxhim. Vazhdoni praktikën më të mira të angazhimit të ekspertëve gjinorë, si RrGK, për të ofruar trajnime dhe mentorim të kontekstit specifik.

PËR QEVERINË E KOSOVËS

- Sigurimi i mbledhjes dhe publikimit të rregullt të të dhënave të ndara sipas gjinisë në përputhje me LBGJ, duke siguruar disponueshmërinë e të dhënave për informimin e procesit të anëtarësimit në BE.
- Vazhdimi i organizimit të konsultimeve kuptimplote me OSHC-të, duke përfshirë OSHCG-të të ndryshme. Të integrojnë kontributin e tyre lidhur me mbledhjet e strukturave të MSA-së. Të sigurohet që OSHC-të e ndryshme, relevante, me ekspertizë dhe njohuri mbi këto çështje, të marrin ftesa për konsultime dhe që konsultimet të jenë të arritshme për sa i përket gjuhës, aftësisë dhe kohës. Jepni komente ose organizoni konsultime të mëtejshme për t'i shpjeguar shoqërisë civile pse disa rekomandime përfshihen në raporte dhe konkluzione, ndërsa të tjerat jo.
- Konsideroni publikimin e të gjitha agjendave dhe konkluzioneve nga mbledhjet e strukturave të MSA-së.
- Vazhdimi i konsultimit me shoqërinë civile, duke përfshirë OSHCG të ndryshme, në rishikimin e PKZMSA-së nga perspektiva gjinore dhe adresimi i rekomandimeve të tyre për integrimin e saj gjinor.
- Institucionalizimi i konsultimeve me OSHCG të ndryshme dhe të kualifikuara gjatë procesit të hartimit të legjislacionit dhe politikave në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE, duke përmirësuar vëmendjen ndaj barazisë gjinore në këto dokumente. Institucionet përkatëse duhet të sigurojnë angazhimin e ekspertëve të OSHC-ve në konsultime dhe grupe pune në fazat e hershme të hartimit të politikave dhe dokumenteve sektoriale (p.sh., përpara konsultimeve publike zyrtare) për të siguruar që vëmendja ndaj barazisë gjinore të jetë e integruar brenda tyre që në fillim dhe për të shmangur çdo strukturë ose barrierat sistematike dhe për të siguruar vëmendje të mjaftueshme ndaj barazisë gjinore në politikën publike.
- Vazhdimi i vënies në dispozicion të projektligjeve dhe politikave për konsultim publik përmes platformës, duke siguruar kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e tyre, veçanërisht për dokumentet më të gjata. Vazhdimi i sigurimit të përfshirjes së kontributit nga OSHCG, drejt rritjes së vëmendjes ndaj barazisë gjinore, si dhe nevojave të grave dhe burrave të ndryshëm brenda politikave publike.
- Të shtohen kapacitetet e zyrtarëve të barazisë gjinore për t'u angazhuar në proceset e politikëbërjes dhe për të siguruar që ata të jenë pjesë e të gjitha grupeve të punës, drejt integritetit të perspektivës gjinore në politikën dhe ligjet e reja. Merrni parasysh caktimin e bursave nga Skema e Celulës së të Rinjëve për studime gjinore, ofrimin e bursave për edukimin e nëpunësve të rinj publik në kryerjen e analizave gjinore dhe përdorimin e saj për të informuar politikën publike.
- Të sigurohet zbatimi i rekomandimeve të KE-së në Raportin aktual dhe të ardhshëm të Kosovës, përfshirë ato që kanë të bëjnë me barazinë gjinore.
- Institucionalizimi i konsultimeve me shoqërinë civile, veçanërisht ekspertët e OSHCG-ve, në procesin e hartimit të dokumenteve të veprimit, në drejtim të sigurimit të vëmendjes së përmirësuar ndaj barazisë gjinore në hartimin fillestar të këtyre dokumenteve.
- Të sigurohet që i gjithë stafi i KKIPA të ketë marrë trajnime bazë lidhur me avancimin e barazisë gjinore si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet KKIPA dhe ABGJ brenda ZKM-së, duke siguruar angazhimin e ABGJ-së në të gjitha proceset që lidhen me anëtarësimin në BE.

- Të sigurohet që zyrtarët e ABGJ-së dhe të barazisë gjinore të konsultohen mjaftueshëm gjatë hartimit fillestar të dokumenteve të veprimit IPA.
- Të sigurohet që ASK të ketë ekspertizë të mjaftueshme gjinore në të gjithë sektorët, të cilët mund të sigurojnë mbledhjen dhe publikimin në kohë të statistikave gjinore.
- Finalizimi i Indeksit të Barazisë Gjinore për Kosovën.

PËR SHOQËRI CIVILE

Përderisa kjo metodologji u fokusua në BE dhe Qeverinë, si bartës të detyrës përgjegjëse për sigurimin e perspektivës gjinore gjatë procesit të anëtarësimit në BE, ajo zbuloi vëzhgime për mënyrat se si shoqëria civile mund t'i mbështesë këto procese:


- OSHC-të me përvojë mund të mbështesin dhe fuqizojnë OSHC të tjera të për të marrë pjesë në procesin e anëtarësimit në BE. Kjo përfshin “përkthimin” e procesit të anëtarësimit në BE në një mënyrë që OSHC të ndryshme të kuptojnë se si ai lidhet me punën e tyre, si dhe mbështetjen e OSHC-ve të ndryshme në formulimin e prioriteteve të tyre dhe shprehjen e tyre gjatë konsultimeve të qeverisë dhe BE-së.
- Të bashkëpunoj për të krijuar një mekanizëm konsultativ të kualifikuar, të zgjedhur në mënyrë demokratike dhe përfaqësues që do të siguronte përfaqësimin e interesave të ndryshme të shoqërisë civile në grupet e punës të sektorit zyrtar kur ato të krijohen në të ardhmen. Përfaqësuesit duhet të zgjidhen, të kualifikohen me ekspertizë adekuate sektoriale dhe të kërkohet të konsultohen, si dhe t'u raportojnë OSHC-ve të tjera, duke siguruar përfaqësim adekuat të interesave të ndryshme.
- Të vazhdoj rishikimi i projektligjeve dhe politikave, duke integruar vëmendjen për barazinë gjinore.
- Vazhdimi i monitorimit të procesit të anëtarësimit në BE, duke u siguruar që ai kujdeset për avancimin e barazisë gjinore.
- Avokat për institucionalizimin e përfshirjes së OSHC-ve në procesin e hartimit dhe zbatimit të Dokumenteve të Veprimit, veçanërisht nga Qeveria.

SHTOJCË

SHTOJCA 1. BURIMET E TË DHËNAVE

Përveç politikave dhe dokumenteve të tjera të përmendura, konsultimet me institucionet dhe organizatat e mëposhtme, janë bërë përmes shkëmbimit të kërkesave të të dhënave ose përmes korrespondencës me email. Kontribuesit e këtij dokumenti janë të renditur sipas rendit alfabetik:

- Agjencia për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit
- Koordinator Kombëtar IPA (KKIPA)
- Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX)
- Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë
- Qendra Kosovare e Studimeve Gjinore
- Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut (SHGMDNJ)
- Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
- Zyra për Integritet Evropian në Zyrën e Kryeministrit



INTEGRIMI I PERSPEKTIVËS GJINORE NË PROCESIN E ANËTARËSIMIT NË BE

Raporti i Vlerësimit për Kosovën

Kosovë

2022

Organizata partnere

